

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

УНИВЕРСИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI JURIDIK

FACULTY OF LAW

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

PUNIM I MAGJISTRATURËS

STUDIME POSTDIPLOMIKE

DREJTIMI JURIDIKO-PENAL

TEMA: “Ekzekutimi i dënimit me burg për fëmijët në Republikën e Maqedonisë së Veriut”

KANDIDATI:

FATMIR MURSELI

MENTOR:

Doc. Dr. BLERTA AHMEDI ARIFI

Dhjetor, 2019

“VËRTETOJ SE UNË JAM AUTOR I KËTIJ PUNIMI”

FATMIR MURSELI

FALEMENDERIM

Së pari, falemenderimi i takon Zotit të Madhëruar i cili na mundësoi që të përjetojmë edhe këtë ditë gëzimi dhe të rëndësishme në familjen time.

Ndjehem me fat që pjesë e këtij rrugëtimi në realizimin e këtij punimi shkencor është mentore Blerta Ahmedi Arifi të cilën e falemenderoj jashtëzakonisht shumë për mundin e dhënë e cila ishte në gjendje që në çdo kohë të më këshillojë, mbështes dhe të më udhëzoj që në kohë të caktuar dhe me sukses të arrij finalizimin e këtij hulumtimi, poashtu falemendroj të gjithë profesorët universitar të cilët më kanë ndihmuar dhe kemi qenë së bashku prej fillimit të studimeve të magjistraturës.

Shfrytëzoj mundësinë që thellësisht nga zemra dhe shpirti të ju falemenderohem dy personave të rëndësishëm në jetën time Gjyshit Salih Murseli dhe Gjyshes Selbije Murseli të cilët vunë themelet në hapat e para të jetës time dhe zhvillimit të personalitetit tim, familjen e cila më ka përkrahur emocionalisht dhe financiarisht nga ditët e para të fillimit të rrugëtimit akademik e duke veçuar sakrificën e prindërve të mi babait Qani Murseli dhe nënës Telime Murseli. Një falemenderim tjetër të përzemërt ia dedikoj të fejuarës time Xhenisë e cila është inspirimi, motivi dhe shtysa ime kryesore.

“Edukimi është gjëja më e mirë që një baba mund t’i jep fëmijës së tij – Muhamedi a.s.”

ABSTRAKT

Qëllimi kryesor i këtij punimi është njohja më funksionimin e ekzekutimit të dënimit me burg te fëmijët në Republikën e Maqedonisë së Veriut, procesin e riedukimit dhe riintegritit në shoqëri, identifikimine faktorëve pozitiv dhe negativ që janë pjesë e enteve të caktuara shtetërore për tretmane të fëmijëve të dënuar me masa të ndryshme, njohja me të dhënat mbi entet e vecanta për tretmanet penitensiare dhe burgu për fëmijë.

Paraqitja e gjendjes reale e këtyre qendrave, burgjeve apo shtëpive edukuese, të dhëna të cialt do të shërbejnë për njoftim tek fëmijët që të ndikohet në uljen e numrit të veprave të ndaluara. Nxjera e të dhënave statistikore rreth numrit të fëmijëve që janë pjesë e këtyre qendrave.

Ligji për drejtësinë e fëmijëve është njëri ndër dokumentet shtetërore që është shfrytëzuar më së shumti në këtë punim, dokument i cili përfshinë të gjitha etapat e zhvillimit të procesit të ekzekutimit të dënimit me burg te fëmijët dhe procesit të risocializimit të tyre.

ABSTRACT

The main purpose of this paper is to introduce the functioning of the prison sentence for children in the Republic of Northern Macedonia, the process of re-education and reintegration into society, identifying the positive and negative factors that are part of certain state institutions for the treatment of children that are sentenced to various measures, getting to know the information on special institutions for penitentiary treatment and prison for children.

A presentation of the real situation of these centers, prisons or educational centers, data which will serve to inform the children in order to influence the decrease of the number of prohibited offenses. Composing statistical data on the number of children that are part of these centers.

The Law on Children's Justice is one of the state documents mostly used in this paper, a document that covers all stages of the development of the process of executing prison sentences

АПСТРАКТ

Главната цел на овој труд е да запознавање со функционирањето на затворската казна за деца во Република Северна Македонија, процесот на реедукација и реинтеграција во општеството, идентификување на позитивните и негативните фактори кои се дел од одредени државни институции за третман на деца кои се осудени на разни мерки, запознавање со податоците за специјалните установи за казнено лекување и затвор за деца.

Презентација на реалната состојба на овие центри, затвори или едукативни центри, податоци што ќе служат за информирање на децата со цел да се влијае на намалувањето на бројот на забранети престапи. Составување статистички податоци за бројот на деца кои се дел од овие центри.

Законот за Правда на Децата е еден од државните документи главно користени во овој труд, документ што ги опфаќа сите фази на развојот на процесот на извршување затворски казни за деца и нивната ресоцијализација.

PËRMBAJTJA

Abstrakti në gjuhën shqipe.....	4
Abstrakti në gjuhën angleze.....	5
Abstrakti në gjuhën maqedone.....	6
Hyrje.....	9-10

Kapitulli I

1. Rregullat e përgjithshme lidhur me ekzekutimin e sanksioneve penale për fëmijë sipas LDF.....	11-12
1.1 Përkufizimi i nocionit fëmijë dhe kategorizimi i fëmijëve sipas LDF.....	12-13
1.2 Mosha minimale për përgjegjësi penale dhe shqiptim të dënimeve për fëmijë.....	14
1.3 Llojet e sanksioneve penale për fëmijë bazuar në specifikat të përcaktuara në LDF..	15-19
1.4 Parimet lidhur me zgjedhjen dhe matjen e sanksionit penale për fëmijë.....	19-23
1.1.1 Dënimi me burg sipas LDF të RMV-së.....	23-25
1.1.2 Kohëzgjatja e dënimit burgim për fëmijë.....	25-26
1.1.3 Qëllimi i dënimit me burgim	26-27
1.1.4 Rrethanat të cilat duhet të merren parasysh gjatë matjes gjyqësore të dënimit burgim për fëmijë.....	28-29
1.1.5 Lirimi nga dënimi sipas LDF.....	30-31
1.1.6 Shlyerja nga evidenca dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për fëmijë.....	31-32

Kapitulli II

2. Ekzekutimi i dënimit me burgim për fëmijë dhe tretmani i fëmijëve të burgosur	33-34
2.1 Procesi i riedukimit dhe riintegrit.....	34-37
2.2 Individualizimi i tretmanit penitenciar si kusht për riedukim të fëmijëve.....	37-38
2.3 Institucioni korrektues për ekzekutim të dënimit me burgim për fëmijë në RMV- Burgu për fëmijë në Ohër.....	38-39

Kapitulli III

3. Mjetet dhe metodat e tretmanit të fëmijëve të dënuar me burgim.....	40-41
3.1 Puna e fëmijëve të dënuar.....	41-42
3.2 Puna e edukatorit.....	43-46
3.3 Puna e psikologut.....	46-47
3.4 Puna e mjekut.....	47-49
3.5 Arsimimi i fëmijëve të dënuar.....	49-52
3.6 Aktivitetet zbavitëse dhe sportive.....	52-53
3.7 Të drejtat dhe obligimet e fëmijëve sipas rendit shtëpiak në objektin e burgut për fëmijë.....	53-54

Kapitulli IV

4. Analizë empirike lidhur me ekzekutimin e dënimit me burgim në REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	55
4.1 Numri i fëmijëve të gjykuar gjatë periudhës kohore: 2013-2018.....	55-58
4.2 Numri i fëmijëve të dënuar me burgim gjatë periudhës kohore: 2013-2018.....	58-64
4.3 Anketë e realizuar me fëmijë të dënuar me burgim.....	64-72
PËRFUNDIM.....	73-74
REKOMANDIME.....	75-76
LITERATURA.....	77-80

Hyrje

Hulumtimi i kësaj teme do të kontribuoj në pasurimin e materialeve shkencore në Fakultetin e Drejtësë në Universitetin e Evropës Juglindore, lidhur me ekzekutimin e dënimit me burg te fëmijët në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Tema mbi ekzekutimin e dënimit me burg për fëmijë do të trajtohet bazuar në legjislacionin pozitiv të sistemit juridiko-penal që rregullon drejtësinë për fëmijë në vendin tonë.

Trajtimi i temës së këtij punimi do të zhvillohet duke u bazuar në burimet kryesore të të drejtës penale për fëmijë: Ligjin mbi drejtësinë për fëmijët të R.M.V. dhe Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, si dhe në analizimin e instrumentave ndërkombëtar që rregullojnë ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj fëmijëve.

Gjithashtu do të konsultohen literatura bashkëkohore nga sfera e shkencës mbi ekzekutimin e sanksioneve penale – Penologjisë, si ajo vendore dhe ndërkombëtare. Poashtu do të paraqitet dhe analizohet numri i fëmijëve të dënuar me dënimin burgim për fëmijë bazuar në të dhënat e publikuara nga Enti Shtetëror statistikor i RMV-së. Poashtu do të trajtohen çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimeve me burg te fëmijët në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke filluar me rregullat e përgjithshme që kanë të bëjnë me ekzekutimin e sanksioneve penale për fëmijë sipas LDF, ku do të njoftohemi me kategorizimin e fëmijëve sipas LDF, mosha prej të cilës u takon përgjegjesia dhe llojet e sanksioneve sipas LDF.

Sa i përket dënimeve do të zgjerohemi në disa pika më të rëndësishme duke filluar prej kohëzgjatjes së dënimeve, qëllimi i dënimit, rrethanat të cilat meren parasysh gjatë matjes së dënimit, lirimi nga dënim dhe shlyerja nga evidenca dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për fëmijë. Poashtu tretmani i fëmijeve të burgosur do të shtjellohet gjatë kapitujve të këtij punimi ku do të njoftohemi me procesin e riedukimit dhe riintegrit, individualizimi i tretmanit penitensiar si kusht për riedukim të fëmijëve, institucioni korrektues për ekzekutim të dënimit me burgimpërfëmijënë RMV- Burgu për fëmijë në Ohër, punën e fëmijëve të dënuar, punën e edukatorit, psikologut, mjekut, arsimimi i fëmijëve të dënuar, aktivitetet zbavitëse dhe sportive, të drejtat dhe obligimet e fëmijëve sipas rendit shtëpiak në objektin e burgut për fëmijë.

Ndërsa të dhënat nga anketat dhe intervistat e zhvilluara do të jenë burim i informacionit për studijues të rinj nëpërmjet të cilave do të pasqyrohet realiteti i dhimbshëm i tretmanit të fëmijëve, kushteve minimale për realizim të procesit të riedukimit dhe risocializimit, me të cilat do të bëhet edhe përmbyllja e punimit.

KAPITULLI I

1. RREGULLA TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE PËR FËMIJË SIPAS LDF

Për secilin veprim që me ligj është parapar se është vepër penale e kryer nga fëmijët do të zbatohen dispozita nga kodi penal dhe ligje të tjera me të cilat parashihen sanksionet përkatëse, qëllimi i sanksionimit të fëmijëve është që fëmijët të mbrohen nga kriminaliteti, dhuna dhe nga çdo formë e rrezikimit të lirive dhe të drejtave të tyre dhe zhvillimit të tyre të drejt, socializimi tyre, edukimi dhe riedukimi, ndihma dhe kujdesi për fëmijët, ndalimi që të mos përsëriten veprat e njejta apo të ndryshme që janë të ndaluara respektivisht për të cilat parashihet sanksionim.

Ç'do fëmijë mbi moshën e përgjegjësisë penale, respektivisht nëse ka arritur atë 16 vjeçare, përveç rasteve kur për shkak të pasojave të rënda të veprës penale të kryer dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme për shqiptimin i ndonjë mase tjetër edukuese, do të sanksionohet me dënim, ndërsa për fëmijët prej moshës 14 deri në 16 vjet për veprime të cilat me ligj parashihen vepër penale mund ti shqiptohen vetëm masa edukuese.

Sipas ligjit për drejtësinë e fëmijëve parashihen këto rregulla lidhur me ekzekutimin e sanksione penale për fëmijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut¹:

- a. Fëmiut prej moshës 14 deri në 16 vjet për veprime të cilat me ligj parashihen si vepër penale mund ti shqiptohen vetëm masa edukuese;
- b. Fëmiut prej moshës 16 deri 18 vjet për veprime të cilat me ligj parashihen si vepër penale munt i shqiptohen masa edukuese, e me përjashtim mund ti shqiptohet dënim ose masë alternative;
- c. Fëmiut prej 16 deri 18 vjet mund të lirohet nga denimi nën kushtet e përgjithshme të përcaktuara e kodin penal;
- d. Fëmiut për veprime qëme ligj parashihen si kundërvajtje mund ti shqiptohen sanksione kundërvajtëse të përcaktuara me këtë ligj;

¹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V-së, nr. 148/2013, neni 34

- e. Fëmiut i shqiptohen masa të sigurisë nën kushte të përcaktuara me Kodin penal dhe me këtë ligj;
- f. Konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore dhe sende të përfituara me eprime të cilat me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kundërvajtje të fëmijëve, kryhet në pajtim me kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Kodin penal.

Është shumë me rëndësi që sanksionet apo masat që i shqiptohen fëmiut ti përgjigjen personalitetit të tij, peshës së veprimit dhe pasojave të saj, që në bazë të ligjit është konstatuar vepër penale ose kundërvajtje.

Nëpërmjet mbikqyrjes së fëmijëve pasi ato janë sanksionuar tentohet aftësimi i tyre profesional dhe zhvillim të drejtë nëpërmje sigurimit të edukimit të tyre dhe riedukimit, socializimi i tyre në shoqëri.

Në rastet kur kemi shqiptim të sanksionit më të rëndë që përbehet me privim nga liria, gjykata është kompetente që në vecanti ti arsyetoj shkaqet për shqiptimin e saj.

1.1 Përkufizimi i nocionit fëmijë dhe kategorizimi i fëmijëve në grupe të ndryshme sipas Ligjit për drejtësinë e fëmijë

Fëmijë është çdo qenie njerëzore midis fazës së lindjes dhe pubertetit, sipas ligjit për drejtësinë e fëmijëve, fëmijë është çdo person deri në moshën 18 vjet.

Ligji për drejtësinë e fëmijëve në mënyrë të detajuar rregullon çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e fëmijëve që janë në konflikte me ligjin apo përfaqësojnë viktimat e krimit, përveç kategorizimit të fëmijëve në ndarje të caktuara sipas moshës dhe cilësive, ky ligj parasheh të gjitha llojet e sanksioneve penale dhe përcakton kushtet në të cilat mund të shqiptohen ato ndaj fëmijëve kryerës të veprave penale².

Kategorizimi i fëmijëve sipas ligjit për drejtësinë e fëmijëve është në këtë mënyrë³:

- **Fëmijë**– është çdo person deri në moshën 18 vjet;

² Ahmedi Arifi B. 2019, Delikuenca e të miturve (Ligjerata të autorizuar), fq.9

³ Ahmedi Arifi B. 2019, Delikuenca e të miturve (Ligjerata të autorizuar), Tetovë, fq. 15-16

- **Fëmijë në rezik** – çdo fëmijë që i ka mbushur shtatë vjet dhe nuk i ka mbushur 18 vjet me pengesa trupore ose pengesa të zhillimit mental, vikimë e dhunës, i lënë pas dore nga aspekti edukues dhe soial, i cili gjendet në gjendje të atillë në të cilën është penguar ose është pamundësuar realizmi i funksionit edukues i prindit/ëve ose tutorit/eve, i cili nuk është përfshirë në sistemin e arsimimit dhe edukimit, i përfshirë në lypësi, endje ose prostitucion, i cili përdor droga dhe substance tjera psikotropike dhe prekursorë ose alkool, e i cili për shkak të gjendjeve të këtilla është ose mund të bie ndesh me ligjin si viktimë ose si dëshitar i veprimit që me ligj është paraparë si kundërvajtje ose veprim që me ligj është parapa si vepër penale;
- **Fëmijë në rrezik deri në moshën 14 vjet** – është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprës së paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose burgim mbi tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur shtatë vjet, e nuk i ka mbushur 14 vjet.
- **Fëmijët në rezik nga 14 deri 18 vjet** – është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit, të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose dënim me burg deri në tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet.
- **Fëmijë që bie ndesh me ligjin nga 14 deri 16 vjet** – është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 16 vjet.
- **Fëmijë që bie ndesh me ligjin mbi 16 vjet** – është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite, i ka mbushur 16 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet.
- **Fëmijë viktimë**- është çdo fëmijë i moshës deri 18 vjet i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndim fizik ose mental, pësime emotive, humbje materiale ose shkelje tjetër ose rrezikim të të drejtave dhe interesave si pasojë e veprimit të kryer me ligj të paraparë si vepër penale.
- **Person më i ri i moshës madhore** – është personi i cili gjatë kohës së gjyqimit për veprim të paraparë me ligj si vepër penale, i ka mbushur 18 vjet e nuk i ka mbushur 21 vjet.

1.2 Mosha minimale për përgjegjësi penale dhe shqiptim të dënimit për fëmijë

Për veprimet që me ligj parashihen si vepra penale dhe këto veprimen kryhen nga fëmijë që janë të moshës prej 14 deri në 16 vjet nuk do t'iu shqiptohet dënim por vetëm masë edukuese, ndërsa nëse fëmija është prej moshës 16 deri në 18 vjet mund ti shqiptohen masa edukuese e me përjashtim edhe dënim e masë alternative. Pra mosha minimale që fëmija mbart përgjegjësi penale dhe që mund të dënohet është 16 vjet.

Sipas ligji mbi drejtësinë e fëmijëve mund të dënohet një fëmijë mbi moshën e përgjegjësisë penale, respektivisht nëse ka arriuar atë 16 vjecare, përvec rasteve kur për shkak të pasojave të rënda të veprës penale të kryer dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme për shqiptimin e masës edukuese, për këtë rast prof.dr. Vllado Kambovski thekson se kushtet ligjore për shqiptimin e dënimeve janë të përcaktuara në frymën e konceptit reributiv, sipast tij ligji (mos) arsyetimi për shqiptimin e masës edukuese nuk e lidh për personalitetin e fëmiut dhe qëllimin e masë edukuese, por për pasojat e rënda të veprës dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale, e kjo në fakt nuk nënkupton gjë tjetër pos pranimin të parimit të dënimit proporcional dhe mund të mbrohet vetëm prej pozicionit të vetëm: ekzistimi i shkallës së lartëtë të përgjegjësisë penale tek i mituri. Me të drejtë ai vlerëson se shqiptimi i dënimit mund të paraqitet si sanksion jashtzakonisht i dobishëm për arritjen e qëllimit që është edukimi dhe riedukimi i fëmiut⁴.

Për veprime që me ligj është paraparësi vepër penale ose kundërvajtje e kryer nga fëmijë, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e kodit penal, si dhe dispozitat e Ligjit për kundërvjtje dhe ligje të tjera në të cilët janë përcaktuar veprimet që me ligj parashihen si kundërvajtje.

Dispozitat e vecanta që vlejné për fëmijë kryerës të veprave penale zbatohen nën kushtet të parapra në dispozitat e këtij kreu edhe ndaj personave të moshës madhore kur u gjykohet për veprimet të cilat me ligj parashihen si vepra penale që i kanë kryer si fëmijë, e me përjashtim edhe ndaj personave që kanë kryer vepër penale sit të mitur të rinj.

⁴ Kambovski V. 2010, E drejta penale, Shkup, fq. 612

1.3 Llojet e sanksioneve penale për fëmijë bazuar në specifika të përcaktuara në Ligjin mbi drejtësinë për fëmijët

Fëmijës të cilit i takon përgjegjësia penale mund që ti shqiptohen këto lloje të sanksioneve⁵:

- Masa edukuese;
- Dënime;
- Masa alternative;
- Masa siguruese.

Masat edukuese- Masat edukuese janë lloj i sanksioneve penale, të parapara me Ligjin mbi drejtësinë e fëmijëve, të cilat i'u shqiptohen fëmijëve në ndeshje me ligjin nga mosha 14-18 vjeçare. Këto paraqesin lloj të posaçëm të sanksioneve penale të cilat mund t'i shqiptohen ekskluzivisht vetëm fëmijëve kryerës të veprave penale, këto masa përbëhen ne mbrojtjen, mbyqyrjen, aftësimin profesional dhe zhvillimin e përgjegjësisë personale të të miturit dhe kanë për qëllim edukimin e tij, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë⁶.

Qëllimi i masave edukuese vërehet nga vetë emërtimi i tyre, i cili konsiston në edukimin apo riedukimin e fëmiut delikuent, parandalimin e veprimeve delikuede e asociale nga fëmijët, socializimin e fëmiut në shoqëri, e assesi dënimin apo shpagimin për të keqen e shkaktuar⁷.

Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve në Republikën e Maqedonise së veriut njeh tre lloje të masave edukuese të cilat mund ti shqiptohen fëmiut që ka arritur moshën 14 deri 18 vjeçare, ato janë⁸:

- a. Qortimi ose dërgimi në qendër për fëmijë;
- b. Masat e mbiqyrjes së përforcuar nga ana e prindërit/ëve, tutorit/ëve, familjes përkujdesëse ose qendrës;
- c. Masat e entit- Dërgimi në institucion edukues ose Dërgimi në Shtëpi edukuese-përmirësuese.

⁵ Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V nr 148/2013

⁶ Kambovski V. 2007, E drejta Penale, fq. 607

⁷ Ahmedi Arifi B. 2019, Delikuenca e të miturve (Ligjerata të autorizuar), Tetovë, fq. 55

⁸ Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V nr 148/2013, neni 37 p.1

Dënimet – sipas ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve mund të dënohet një fëmijë mbi moshën e përgjegjësisë penale, respektivisht nëse ka arritur atë 16 vjecare, përveç rasteve kur për shkak të pasojave të rënda të veprës penale të kryer dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme shqiptimi i masave edukuese⁹.

Llojet e dënimeve janë¹⁰:

- a. Burgu për fëmijë;
- b. Dënimi me para;
- c. Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik ose kategorisë së caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi.

Burgu për fëmijë:

Sipas ligjit për drejtësi të fëmijëve dënimi me burg mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor, dënimi me burg mund të shqiptohet vetëm në rastet kur fëmija ka kryer vepër penale për të cilën parashihet dënim prej pesë vitesh burg ose dënim më i rëndë, nëse vëpra është kryer në shkallë të lartë të përgjegjësisë penale të kryerësit dhe nuk do të ishte e arsyeshme ti shqiptohet masë edukuese. Burgu për fëmijë nuk mund të jetë më i shkurtër se 1 vjet dhe më i gjatë e 10 vite kurse shqiptohet në vite të plota ose gjysëm viti.

Gjatë caktimit të dënimit, gjykata nuk mund të shqiptojë burg për fëmijë në kohëzgjatje më të gjatë nga dënimi i përcaktuar për atë vepër, por gjykata nuk është e lidhur për masën më të vogël të përcaktuar të atij dënimi. Kështu p.sh. kur si maksimum i posaçëm për veprën e kryer është përcaktuar dënim me burg deri 8 vjet, gjyqi nuk mund të shqiptojë dënim mbi atë maksimum, por gjithmonë mund të ulet nën minimumin e përgjithshëm të dënimit me burg deri në një vit kohëzgjatje¹¹.

Në rastet kur riedukimi është i suksesshëm, fëmiju mund të lëshohet në lirim me kusht nëse e ka vuajtur të paktën një të tretën e dënimit dhe jo para se ë vuajë një vit nga dënimi i shqiptuar,

⁹ Poaty, neni 50

¹⁰ Po aty, neni 51

¹¹ Kmbovski V. 2007, E drejta Penale, Shkup, fq. 612

ndërsa nëse fëmiut i është shqiptuar dënim me burg për fëmijë deri në dy vite e gjashtë muaj, mund të lëshohet në lirim me kusht në një të tretën e dënimit të shqiptuar.

Gjatë kohës së lirit me kusht gjykata i cakton masën e mbikqyrjes së përforcuar nga ana e qendrës në kohëzgjatje të caktuar, e cila mund të jetë edhe më e shkurtër e pjese e pavuajtur e dënimit, poashtu kohezgjatja e mbikqyrjes mund të zgjatet deri në moshën 21 vjecare të të dënuarit.

Gjykata mund edhe të revokojë lirimin me kusht nëse fëmiu nuk i plotëson obligimet e parapara me mbikqyrjen e përforcuar ose nëse deri sa është në lirim me kusht kryen një ose më shumë veprime të parapara me ligj si vepra penale për të cilat është shqiptuar dënim me burg për fëmijë mbi dy vite ose dënim me para, gjykata mund të revokojë lirimin me kusht duke i pasur parasysh ngjashmërinë e veprave të kryera, rëndësinë e tyre, nxitjet nga të cilat janë kryer dhe rrethanat tjera që sugjerojnë në arsyeshmërine për revokimin e lirit me kusht.

Dënim me para – shqiptohet si dënim kryesor për veprat e kryera nga lakmia e përfiimi, dënimi me para mund të shqiptohet si dënim dytësor së bashku me dënimin me burg për fëmijë ose dënimin me kusht me mbikqyrje të përforcuar, dënimi me para shqiptohet me gjoba ditore ndërsa numri i gjobave nuk mund të jetë më i vogël se një as mëi madh se 120 gjoba ditore, lidhur me matjen dhe zbatimin e dënimit me para në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Kodit Penal¹².

Në rastet kur dënimi me para nuk paguhet, gjykata ka të drejtë ta zëvendësojë me masë alternative që mund të jetë punë me dobi të përgjithshme, një gjobë ditore zëvendësohet me tri orë të punës, numri i përgjithshëm i orëve të punës nuk mund të jetë mëi madh se 100 orë me dobi të përgjithshme. Në rastet kur edhe masat alternative nuk kryehen ose kryehen pjesërisht si rastet me punë me dobi të përgjithshme, gjykata mund të dërgojë fëmijën në qendrën për fëmijë, ose me masë mbikqyrje e përforcuar.

Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik të llojit ose kategorisë të caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi – Sipas ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve ndalimi i drejtimit të automjetit motorik të

¹² Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V-së nr. 148/2013, neni 54

llojit ose kategorisë të caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi mund të shqiptohen si dënime kryesore ose dytësore së bashku me dënimin me para¹³. Ky lloj i dënimit shqiptohet me kushte për shqiptimin e tij të parapar ne Kodin penal.

Masat alternative – Masat alternative mund të shqiptohen ndaj fëmiut mbi moshën 16 vjeçare me qëllim që të mos shqiptohet dënimi kur kjo nuk është e detyrueshme për pengimin e kryerjes së veprimeve që me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kur mund të pritët paralajmërimi me kërcënim të dënimi dhe zbatimi i masave të ndihmës, mbrojtjes dhe mbikqyrjes në liri, mjaftueshëm do të ndikojnë në edukimin, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë të tij,

Llojet e masave alternative janë¹⁴:

- a. Dënimi me kusht me mbikqyrje të përforcuar;
- b. Nërprerje me kusht të mbajtjes së procedurës ndaj fëmiut;
- c. Puna në dobi të përgjithshme.

Dispozitat e Kodit penal për masa alternative vlejnë edhe me shqiptimin e tyre ndaj fëmijëve mbi moshën 16 vjet, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, qëllimi i masave alternative është që për përgjegjësi penale ndaj fëmiut mbi moshën 16 vjet të mos zbatohet dënim kur kjo nuk është e detyrueshme për pengimin e kryerjes së veprimeve që me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kur mund të pritët se paralajmërimi me kërcënim të dënimit dhe zbatimi i masave ndihmëse, mbrojtjes dhe mbikëqyrjes në liri, mjaftueshëm do të ndikojë në edukimin, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë të tij¹⁵.

Masat siguruese – Sipas ligjit për drejtësinë e fëmijëve nën kushte të përcaktuara me Kodin Penal ndaj fëmiut të gjykuar me masën edukuese ose dënimin me burg për fëmijë mund të shqiptohet masat e sigurisë, ndaj fëmiut të papërgjegjshëm nën kushtet e përcaktuara me Kodin Penal,

¹³ Ahmedi Arifi B. 2019, Delikuenca e të miturve (Ligjerata të autorizuar), Tetovë, fq. 66

¹⁴ Po aty, fq. 66

¹⁵ Po aty, fq. 68

Masat e sigurisë që mund të shqiptohen janë¹⁶:

- a. Mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor;
- b. Mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri;
- c. Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve nga Kodi penal, si masë e mjekimit të detyrueshëm të fëmijut nga varshmëritë, mund të shqiptohet dhe pas shqiptimit të masës edukuese ose dënimit, kur masa Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve shqiptohen me masën edukuese ose dënimin, ajo zbatohet në seksion të specializuar të institucionit, koha e kaluar në institucion për zbatimin e masës së sigurisë llogaritet në dënimin e shqiptuar me burg për fëmijë ose masës së entit, pas zbatimit të masës së sigurisë, gjykata do të vendosë nëse do të vazhdojë realizimi i dënimit me burg për fëmijë apo masa e entit.

1.4 Parime lidhur me zgjedhjen dhe matjen e sanksionit penal për fëmijë

Funksionimi i të drejtës penale për fëmijë përcaktohet prej parimeve themelore saktësisht prej nenit 3 deri 18 të ligjit për drejtësinë e fëmijëve, të cilat do ti sqarojme në vazhdim, si të tilla janë këto parime: E drejta e përdorimit të gjuhës; E drejta për tu informar në çdo fazë të procedurës penale; Ndalimi i diskriminimit mbi çfardo baze; Parimi i ligjshmërisë; Ndalimi i trajtimit miozor, ç'njerëzor dhe degradues; Privimi nga liria i të miturve vetëm si mjet i fundit në procedurë, duke mbrojtur interesin e fëmijës për edukim; E drejta e ankesës; Prioriteti i masave parandaluese, edukuese dhe të mbrojtjes; Parimi i individualizmit të dënimit.

- E drejta e përdorimit të gjuhës parashihe si e drejtë që e ka fëmiju në procedurë në nenin 3 të këtij ligji, i cili përcakton se në procedurë, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, më tej theksohet se dispozitat e ligjit për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe njësitë e vetëadministrimit lokal në mënyrë adekuate të zbatohet në procedurë ndaj fëmijëve, fëmiju shtetas i huaj i privuar nga liria ose në paraburim, parashtresat në

¹⁶ Po aty, fq. 70

procedurëmund ti parashtrojë në gjuhën e vet, ndërsa në raste të tjera në kushte të reciprocitetit¹⁷.

- E drejta për tu informuar fëmiju ka të drejtë të informohet nga të gjitha institucionet, që janë në lidhje me të, për të drejtat e tij, të cilat përfshijnë obligime dhe përgjegjësi me Konventën për të drejtat e fëmiut dhe dokumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e fëmiut më këtë ligj dhe me ligje të tjera. Fëmiu ka të drejtë të merret në pyetje, të degjohet dhe të këshillohet për të drejtat në atë procedure dhe për vetë procedurën. Në cdo procedurëgjyqësore dhe jashtëgjyqësore në të cilën merr pjesë, fëmiu ka të drejtë në mënyrë aktive të marrë pjesë në marrjen e vendimeve për jetën e tij dhe ta japë mendimin e vet¹⁸.
- Fëmiut mbi moshën 14 vjet nuk mund ti shqiptohen sanksione për veprën e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë eparaparë me ligj si vepër penale ose si kundërvajtje dhe për të cilën nuk është pëcaktuar sanksion me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare¹⁹.
- Fëmijët viktimatë veprave penale që me ligj janë paraparë si vepra penale i kanë të drejtat e njejta qëi kanë edhe personat viktimatë të moshës madhore, para, gjatë kohës dhe pas përrundimi të procedurës penale, si dhe të drejtat e vecana të pranuar me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet e tjera të ratifikuara. Fëmijët viktimatë të veprave, të cilat me ligj janë paraparë vepra penale dhe fëmijët dëshmitarë gëzojnë mbrojtje të përforcuar dhe përkrahje nga të gjitha institucionet, organet dhe individët në sistemin për drejtësi për fëmijë, me qëllim që të zvogëlohen pasojat negative mbi ta nga vepra penale dhe të pengohet ndikimi negativ i veprimit të

¹⁷ Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V-së nr 148/2013, neni 3

¹⁸ Po aty, neni 4

¹⁹ Po aty, neni 5

institucioneve mbi zhvillimin e drejtë të fëmijës dhe të nxiten të kërkojnë mbrojtje para gjykatës kompetente²⁰.

- Fëmiut mbi moshën 14 vjet në veprim joformal të organeve dhe shërbimeve kompetente, si dhe në procedurën gjyqësore, i garantohen të drejtat e njejta që kanë personat e moshës madhore të akuzuar në procedurë penale ose kundërvajtëse, si dhe të drejtat e vecanta të pranuar me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet tjera të ratifikuara, në të gjitha fazat e procedurës dhe në shqiptimin e cilit do sanksion ose masë të paraparë me ligj. Nuk mund të konsiderohet për se fëmija bie ndesh me ligjin deri sa kjo nuk përcaktohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor. Gjatë veprimit gjykata dhe institucionet tjera në zbatimin e dispozitave të LDF, qëllim kryesor e kanë realizimin e interesave më të mira për fëmijun²¹.
- Gjykata dhe institucionet tjeranë zbatimin e LDF i respektojnë dhe sigurojnë të drejtat e fëmijës pa asnjë diskriminim, pa dallim të gjinësë, racës, ngjyrë së lëkurës, përkatësisë së grupit të argjinalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, origjinës, sociale, religjionit ose besimit fetar, llojeve tjera të besimit, shkollomit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesave mentale dhe trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore ose çfarido qoftë tjetër përveç asaj që është paraparë me ligj ose me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare, të prindit/ëve, ose tutorit/ëve ose anëtarëve të familjes së fëmijës. Gjykata dhe institucionet tjera gjatë zbatimit të këtij ligji ndërmarrin të gjithë masat e nevojshme për sigurimin e mbrojtjes së fëmiut nga të gjitha llojet e diskriminimit ose sanksionit ose kufizimeve tjera të të drejtave në bazat e parapara në paragrafin 1 të këtij ligji²².

²⁰ Po aty, neni 6

²¹ Po aty, neni 7

²² Po aty, neni 8

- Asnjë fëmijë nuk guxon ti ekspozohet mundimit, veprimeve ose sanksioneve tjera mizore, çonjerëzore ose poshtëruese. Fëmiju cdo herë ka të drejtë për mbrojtje të përforcuar nga mundimi dhe veprimet ose sanksionet tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese²³.
- Privimi i fëmiut nga liria zbatohet vetëm si mjet i fundit në procedurë, dhe vetëm në kushte dhe në kohëzgjatje të përcaktuar me këtë ligj²⁴.
- Çdo veprim në gjykatë dhe në institucione tjera me fëmijë në zbatimin e dispozitave të LDF duhet të zgjasë dhe të përfundoj në afat të arsyeshëm, që nuk do ti dëmtojë interesat e tij²⁵.
- Fëmiu, ose përfaqësuesi ligjor i tij ka të drejtë informimi për rrjedhën e veprimit dhe të drejtën e ankesës dhe parashtresës për mbrojtjen e të drejtave të Avokati i Popullit dhe organet e institucionet tjera të cilat kanë kompetencë që të kujdesen për të drejtat e fëmiut²⁶.
- Zbatimi i masave dhe sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj dhe veprimi me fëmijën janë paraprë në interes të tij për mbrojtje, edukimi, riedukimi dhe zhvillim të drejtë²⁷.
- Veprimi në gjykatë dhe në institucione tjera gjatë shqiptimit dhe ekzekutimit të sanksioneve dhe masave tjera duhet ti përshtatet moshës, personalitetit, nevojave dhe intereseve të fëmiut. Gjatë zbatimit të masave në procedurat e përcaktuara me këtë ligj fëmiut mbi 14 vjet mund ti merren ose kufizohen të drejta të caktuara vetëm në masë që i përgjigjet shkallës së arritur të zhvillimit dhe personalitetit të tij dhe të nevojës së tij për mënjanimin e faktorëve që ndikojnë tek ai të kryejë veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale ose kundërvajtje²⁸.
- Gjatë vendosjes për zbatimin e masave dhe sanksioneve të përcaktuara me LDF, çdo herë u jepet përparësi masave preventive, mbrojtëse dhe edukuese²⁹.

²³ Po aty, neni 9

²⁴ Po aty, neni 10

²⁵ Po aty, neni 11

²⁶ Po aty, neni 12

²⁷ Po aty, neni 13

²⁸ Po aty, neni 14

²⁹ Po aty, neni 15

- Masa ose sanksioni që i shqiptohet fëmijut mbi 14 vjet duhet ti përgjigjet personalitetit të tij, peshës së veprimit që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje dhe pasojave të saj, nevojës për edukimin, riedukimin, arsimimin dhe zhillimin e tij, për shkak të sigurimit të mbrojtjes së interesit që është më i volitshëm për fëmijën³⁰.
- Procedura gjyqësore sipas rregullës iniciohet vetëm për rastet e parapara si vepër penale me këtë ligj, nëse fëmija mbi 14 vjet ka kryer vepër penale që është paraparë si vepër penale për të cilën shqiptohet dënim me burg prej tri vitesh ose dënim i rëndë, ose në rastet kur qëllimi i masave ose sanksioneve të përcaktuara me LDF nuk mund të arrihet pa procedurë të tillë³¹.
- Procedurën ndaj fëmijëve e zhvillon edhe sanksionet e përcaktuara me këtë ligj i shqipton vetëm gjykata kompetente, masa tjera të parapara me këtë ligj mund të shqiptojnë edhe organet tjera të specializuara³².

1.1.1 DËNIMI ME BURG SIPAS LDF TË RMV

Qëllimi i dënimit me burgim të fëmijëve është edukimi i tyre, riedukimi i tyre, socializimi, zhvillimi i duhur i fëmijës. Nevoja e dënimit me burg në raste të caktuara është e patjetërsueshme me anë të së cilës do të tentohet të rregullohet pozita e fëmijës në shoqëri. Dënimet për fëmijë bazohen në veprën e penale të kryer dhe në rrethana të ndryshme që kanë të bëjnë me veprën penale, vazhdimisht tentohet eliminimi i arsyeve të cilat kanë shtyrë fëmijun në rrugën për kryerjen e veprës penale, duhet pasur parasysh se vendimi për dënim të fëmijëve për veprimet e ndërmara nuk është prioritet sic është në procedurën penale ndaj të rriturve.

Dënimi me burg konsiderohet si mjet i aparatit shtetëror me anë të së cilit do të mbrojë shoqërinë nga kriminaliteti dhe si i tillë është dënim kryesor, dënimi me burg konsiderohet si masa më e fortë të cilën e ka në dispozicion shteti për tu kujdesur për shoqërinë, për të mbrojtur shoqërinë, të mirat e vendit dhe të fëmijëve.

³⁰ Po aty, neni 16

³¹ Po aty, neni 17

³² Po aty, neni 18

Dënimi i shqiptuar për fëmijë duhet të korespondojë me personalitetin e tij, duke marrë parasysh natyrën e veprimit të parapar me ligj si vepër penale apo kundërvajtje, duke i analizuar pasojat e edukimit dhe riedukimit të tij, me qëllim të mbrojtës së interesave të fëmijut.

Dënimet parashihen si mjete apo mënyra e fundit e cila duhet që të i'u shqiptohet fëmijëve, në fillim meren në konsideratë të gjitha mundësitë për anashkalim të dënimit me burg dhe të gjitha mundësitë për ekzekutimin e masave të tjera edukuese.

Përgjegjësia penale i takon fëmijës i cili është mbi moshën 16 vjet, sipas ligjit për drejtësinë e fëmijëve dënim me burg mund ti shqiptohet kësaj kategorie të fëmijëve që kanë mbushur moshën për përgjegjësi nëse kanë kryer veprim që me ligj është paraparë si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej pesë vitesh osë dënim më i rëndë nëse vepra është kryer në rrethana rënduese dhe në shkallë të lartë të përgjegjësisë penale të kryerësit dhe me çrast nuk do të ishte e arsyeshme që të shqiptohet masë edukuese.

Drejtësia penale rregullohet edhe me norma dhe standarte nga Konventa e OKB-së e cila u ratifikua nga Republika e Maqedonisë së Veriut më 2 Dhjetor 1993, sipas Konventës parimet më të përgjithshme për realizimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve janë: Mosdiskriminimi i fëmijëve, respektimi i interesit më të mirë të fëmijës dhe pjesëmarrja e fëmijës në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën³³.

Shtetet palë duhet të sigurojnë:

- Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, ç'njerëzore ose poshtëruese, as dënim me vdekje, as burgim i përjetshëm nuk duhet të jepet për shkelje të ligjit të kryera nga persona nën 18 vjeç;
- Anjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare, arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër;

³³ Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës 1989 (Convention on the Rights of the Child-(CRC))

- Ç’do fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë, që të kihet parasysh nevojat e personave të moshës së tij, në veçanti, ç’do fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhjen me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;
- Ç’do fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t’i jepet menjëhere ndihmë juridike ose ç’do ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavaruar dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për ç’do rast të tillë³⁴.

Konventën për të drejtat e fëmijëve e kanë ratifikuar shumica e vendeve në botë, më shumë se ç’do konventë tjetër ndërkombëtare, si përpunim apo operacionalizim të të drejtave të drejtësisë për të mitur, janë miratuar disa rregullore ndërkombëtare lidhur me gjyqësinë për të mitur, siç janë standartet minimale ndërkombëtare për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria (rregullat e Havanës), për zbatimin e drejtësisë për të mitur (Rregullat e Pekinit) dhe parandalimin e delikuençës së të miturve (Rregullart e Rijadit)³⁵.

1.1.2 Kohëzgjatja e dënimit me burg për fëmijë

Burgu për fëmijë është dënimi kryesor që mund t’iu shqiptohet fëmijëve që kanë mbushur moshën 16 vjeçare dhe dënimi nuk mund të jetë më i shkurtër se një vit dhe as më i gjatë se dhjetë vite ndërsa mund të shqiptohet në vite të plota ose gjysmë vite, gjykata gjatë caktimit të dënimit nuk mund të shqiptojë dënim më të gjatë nga dënimi i përcaktuar për atë vepër³⁶.

Nëse fëmija ka vuajtur një vit nga dënimi i shqituar dhe nëse periudha një vjeçare plotëson një të tretën e dënimit dhe nëse riedukimi është i suksesshëm atëherë ai fëmijë mund të lëshohet në lirim me kusht.

³⁴ Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës 1989 (Convention on the Rights of the Child-(CRC))

³⁵ Ahmedi Arifi B. 2019, Delikuenca e të miturve (Ligjerata të autorizuar), Tetovë, fq. 76

³⁶ Лажетиќ Бужаровска Г. Нанев Л. Кошевалиска О. 2015, Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Скопје, стр. 155

Gjykata nuk mundet që të shqiptojë burg për fëmijë në kohëzgjatje më të gjatë nga dënimi i përcaktuar për atë vepër, mirëpo mund të ulet në minimum e përgjithshëm deri në një vit kohëzgjatje. Gjykata mund të zgjasë kohëzgjatjen e mbikqyrejes së përforcuar edhe një vit pas dënimit, por jo më shumë se moshë 21 vjeçare e të dënuarit.

Gjykata ka të drejtë që lirimin me kusht të fëmijës ta tërheq nëse gjatë kohës së lirit me kusht nuk i përmbush përgjegjësitë e parapara nga mbikëqyrja e përforcuar dhe nëse gjatë kësaj periudhe kryen një ose me shumë vepra që me ligj janë paraparë si vepra penale për të cilat parashihet dënim për fëmijë deri në dy vjet.

Në rastet kur gjyqi do të tërheq lirimin me kusht për arsyet kur fëmiju ka kryer vepër penale gjatë kësaj periudhe, gjyqi atij fëmiu do ti shqiptoj dënim të ri.

Kur gjykata nuk do ta revokojë lirimin me kusht, ai vazhdohet për kohën që fëmija i dënuar e ka kaluar në vuajtjen e dënim burg për fëmijë të shqiptuar për veprën e re³⁷.

Fëmijët mbajnë dënimin me burgim për fëmijë në institucione korrektuese deri sa të mbushin moshën 23 vjeçare, nëse deri në atë moshë nuk e kanë mbajtur dënimin e plotë ata do të transferohen në institucione korektuese për të ritur. Në raste të vecanta personat e dënuar që kanë mbushur moshën 23 vjet, mund tu lejohet qëndrimi në institucionin korektues për të mitur, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e përgaditjeve ose aftësimin profesional të tyre, apo nëse pjesa e mbetur e dënimit të tyre që duhet mbajtur nuk është më e gjatë se 6 muaj³⁸.

1.1.3 Qëllimi i dënimit me burgim

Qëllimi i dënimit me burgim të fëmijëve në radhe të parë është edukimi i fëmijëve, risocializimi dhe mbrojtja e interesave të tyre, respektivisht preventiva e dlikuencës së fëmijëve.

Dënimi me burg konsiderohet edhe si formë e kompenzimit të dëmit dhe plotësimit të nevojave për ndërprerjen e veprave penale, aftësimin të tyre profesional dhe parandalimit të shëndrimit

³⁷ Ligji për drejtësinë e fëmijëve 2013, Gazeta Zyrtare e R.M.V-së, nr. 148/2013, neni 53 p.6

³⁸ Halili R. 2014, Penologjia, Prishtinë, fq. 273

në recidiv dhe kryerës të vazhdueshëm të veprave që sipas ligjit të Repbulikës së Maqedonisë së Veriut konsiderohen vepra penale ose kundërvajtje.

Hakmarja për veprën e kryer apo shpagimi nëpërmjet dënimit me burg nuk është qëllim i dënimit për fëmijë, qëllimi i hakmarjes nuk është prezent në asnjë sanksion bashkëkohor, por qëllimi i dënimit është përmirësimi i fëmijve delikuentë, që në të ardhmen të mos përsërisin veprimin e njejtë apo tëndryshëm që sipas ligjit është përcaktuar veper penale.

Qëllimi i dënimit është zvogëlimi i shkallës së krimit, ku përveç sanksionimit të kryerësit frikësohet jo vetëm kryerësi i veprës penale por edhe të tjerët për t'ua hequr guximin për të kryer vepra të tjera.

Qëllimi i dënimeve është përjekje dhe zgjidhje konkrete pozitive ligjore në shumë shtete, është afrimi i mbrojtjes dhe ndihmës fëmijëve delikuate, duke ushtruar mbikëqyrje dhe kontroll ndaj tyre duke i aftësuar ata gjatë qëndrimit nëpër institucione të vecanta dhe duke zhvilluar përgjegjësinë e tyre personale që në të ardhmen të formohen dhe të krijohen si qytetarë të ndershëm dhe korrektë.

Qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribohet në rehabilitimin dhe riedukimin e të miturit dhe aftësimin e tij profesional. Po ashtu ky dënim duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recedivizmin.³⁹

Nëpërmjet dënimit me burg përpiqet që në mënyrë sistematike të flakë dhe evitojë faktorët dhe ndikimet kriminogjene e veçmas t'i menjanojë shprehinë devijuese të personave të dënuar. Nga ana tjetër, me një punë të parreshtur angazhohet të ndryshojë personalitetin e të dënuarit duke krijuar shprehinë e reja të punës, duke nxitë virtyte, qëndrime e sjellje pozitive dhe duke kultivuar raporte të shëndosha ndaj personave të tjerë të dënuar. Po ashtu, ky sektor ka për detyrë që personit të dënuar t'i ndihmojë për mbajtjen e kontakteve me familjen dhe për kryerjen e obligimeve të nryshime familjere edhe gjatë kohës sa gjendet në burg⁴⁰

³⁹ Halili R. 2014, Penologjia, Prishtinë, fq. 271

⁴⁰ Halili R. 2010, Penologjia, Prishtinë, fq. 203

1.1.4 Rrethanat të cilat duhet të merren parasysh gjatë matjes gjyqësore të dënimit burgim për fëmijë

Gjatë matjes së dënimit burg për fëmijë, gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë dënimi të jetë më i madh ose më i vogël, të përcaktuara në Kodin penal, duke mbajtur llogari të vecantë për shkallën e zhvillimit shpirtëror, mendor të fëmijës dhe për kohën e nevojshme për edukimin, riedukimin dhe përsosjen profesionale⁴¹.

Me matjen e dënimit nënkuptojmë caktimin e llojit dhe të lartësisë së dënimit kryerësit të veprës penale, gjatë matjes së dënimit duhet me doemos të meren parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese që janë shprehur në momentin e kryerjes së veprës penale, në mënyrë që të caktohet ai lloj dhe masë e dënimit i cili do ti përgjigjet peshës së veprës së kryer penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të kryerësit dhe me të cilën më së miri do të arrihej qëllimi i dënimit, matjen gjyqësore të dënimit e bën gjykata kur në procedurën penale konstatohet se kryerësi i veprës së caktuar penale është penalisht përgjegjës për veprën e kryer, matjen gjyqësore të dënimit e njohin të gjitha të drejtat penale bashkëkohore⁴².

Në bazë të rrethanave të cilat merren parasysh gjatë matjes gjyqësore të dënimit me burg për fëmijë mund të jenë lehtësuese dhe rënduese, me rrethana lehtësuese nënkuptojmë që dënimi të jetë më i butë, gjithashtu brenda kufijve të përcaktuar me ligj, ndërsa me rrethana rënduese nënkuptojmë rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i rreptë brenda kufijve të paraparë me ligj.

Si rrethana që duhet të merren parasysh gjatë matjes së dënimit gjyqësor janë:

- a. Shkalla e përgjegjësisë penale – duhet pasur parasysh se cila ka qenë mënyra e kryerjes se veprimit të ndaluar, e cila mund të jetë nga pakujdesia, me vetëdije apo pa vetëdije, duke u bazuar në këto rrethana do të merret vendimi me burgim;
- b. Motivet nga të cilat është kryer vepra penale – në shumë raste të fëmijët paraqiten problem psikike si rezultat i kryerjes së veprës penale, motive të cilat mund të shtyjnë

⁴¹ Ligji për drejtësinë e fëmijëve 2013, Gazeta Zyrtare e R.M.V nr 148/2013, neni 52

⁴² Salihu I 2012, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2012, fq. 491-492

fëmijën të kryej veper penale mund të jenë të ndryshme si dhembshuria, dashuria, xhelozia, urejtja, egoizmi etj.

- c. Pranimi i fajit – konsiderohet si një nder rethanat të rëndësishme që do të ndikojë në matjen e dënimit gjyqësor, sipas kësaj teorie në qoftë se fëmiu do të pranojë se ka kryer vepër penale do të pranohet fajin do të kupton se veprimi i tilli i ka shkaktuar dëm personit tjetër dhe shoqërisë, kjo jep shenjë se fëmiju është penduar dhe kjo rethanë duhet të jetë lehtësuese për marrjen e vendimit gjyqësor, mirëpo në rast të kundërt nëse fëmija nuk pranohet fajin, kjo jep shenjë se ai nuk e ka kuptuar apo nuk dëshiron ta kuptojë se ka kryer vepër të dëmshme e cila me ligjin për drejtësinë e fëmijëve është parapar si vepër penale dhe kjo rethanë mund të jetë indikacion se fëmiju në të ardhmen do të kryej vepër penale.

Duke marrë parasysh të gjitha rethanat që mund të ndikojnë në matjen e vendimit me burg për fëmijë mund të konstatoj se cila do qoftë rethanë që do të ndikojë në marrjen e vendimit për burg për fëmijë është se tentohet të arihet qëllimi në mënyrë sa më efektive, të cilat janë: risocializimi i fëmijëve, edukimi, riedukimi, pendimi, ndalimi i kriminalitetit të fëmijëve, aftësimi i tij profesional, zhvillimi profesional, zhvillimi arsimor, zhvillimi mental si dhe qëllimi të tjera në dobi të fëmijëve, pra rethanat që do të meren parasysh gjatë matjes gjyqësore të dënimit janë në të mirë të fëmijëve, për dallim nga dënimi për të ritur, te fëmijët këto masa konsiderohen si masa me anë të së cilës nuk tentohet shpagimi i fajit, por vetitë dhe karakteristikat personale të fëmijës të cilat u përmendën më lartë që do të ndikojnë në përmirësimin e tij dhe adaptimin në shoqëri në të ardhmen.

1.1.5 Lirimi nga dënimi sipas Ligji mbi drejtësinë për fëmijë

Kur gjykata sipas dispozitave të përgjithsme të Kodit penal do të shpallë fëmijën fajtor dhe do ta lirojë nga dënimi, mund ti shqiptojë edhe masë edukuese⁴³. Gjkata mund të lirojë kryerësin e veprës penale vetëm në rastet kur shprehimisht parashihet me ligj lirimi nga dënimi.

Dënimet janë masa që ndërmeren për kryerjen e veprimeve që me ligjin për drejtësinë e fëmijëve janë të përcaktuara si vepra penale, mirëpo gjykata në disa raste konstaton se veprimi i caktuar është veprim që duhet të dënohet, mirëpo shqiptimi i dënimit nuk është i arsyeshëm për shkak të instensitetit të vogël të veprës, në raste të tilla gjykata me ligj është autorizuar që kryerësin ta shpallë fajtor, por edhe ta lirojë nga dënimi, gjykata mund të marrë këtë vendim vetëm kur ligji shprehimisht e prashet këtë mundësi, pra gjykata nuk mundet sipas bindjes së vet të lirë të lirojë fëmijun nga dënimi.

Në rastet ur legjislacioni penal parasheh mundësinë e lirimit nga dënimi, gjykata është autorizuar që kryerësit të veprës penale t'ia zbusë dënimin pa kufizime të parapara për zbutjen e dënimit, rrjedhimisht kur gjykata është e autorizuar që kryerësin e veprës penale ta lirojë nga dënimi, ajo mund t'ia zbusë dënimin nën minimumin e posaçëm të dënimit dhe atë deri në minimumin e përgjithshëm të atij lloji të dënimit, madje që në vend të dënimit të paraparë, t'ia shqiptojë një lloj më të butë të dënimit, p.sh. në vend të dënimit me burg mund të shqiptojë dënim alternativ⁴⁴.

Lirimi nga dënimi vjen në shprehje në rastet kur me anë të dënimit mundësitë për të aritur qëllimin e dënimit janë shumë të vogla, kjo veti vjen në shprehje në rastet kur veprimi i caktuar që konsiderohet si veprim i ndaluar dhe vepër penale sipas ligjit për drejtësinë e fëmijë do të kryet nga pakujdesia si dhe në rastet kur kryerësi pasi ka kryer veprën ka tentuar që të përmirësojë dëmin e shkaktuar ku në masë të madhe ka aritur që të kompenzojë dëmin e shkaktuar nga ajo vepër.

⁴³ Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V-së, nr. 148/2013, neni 57

⁴⁴ Salihu I. 2012, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, fq. 503

Për zbatimin e kësaj dispozite gjykata duhet të konstatojë nëse janë përmbushur të gjitha kushtet si dhe ti cekë rrethanat në të cilat e mbështetë aktgjykimin me të cilin e liron kryerësin nga dënimi. Përkatësisht në këto situata gjyka e nxjerrë aktgjykimin me të cilin e shpallë fajtor kryerësin e veprës penale por e liron nga dënimi.⁴⁵

Në rastet kur edukimi, riedukimi, risocializmi është aritur para përmbushjes së dënimit të parapar, në qoftëse fëmiu ka pasur sjellje të mirë suksese në qëllimin për të cilin është sanksionuar dhe nëse fëmiu ka mbajtur tre të katërtën e dënimit, drejtori i institucionit korektues mund ta lirojë fëmiun e dënuar para mbajtjes së dënimit të tij të plotë.

1.1.6 Shlyerja nga evidenca dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për fëmijë

Të dënat për sanksionet e shqiptuara mund ti jepen vetëm gjykatës, prokurorit publik dhe institucioneve që merren me mbrojtjen e fëmijëve, lidhur me procedurën e re që udhëhiqet ndaj fëmijës ose personit më të ri të moshës madhore për veprim të kryer që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje⁴⁶.

Të dhënat për masat e shqiptuara qortim ose dërgim në qendër të fëmijëve, masat e mbikqyrjes së përforcuar dhe sanksionet kundërvajtëse fshihen nga e videnca kur do të kalojë një vit nga zbatimi ose parashkrimi i tyre, nëse fëmiu ose personi i ri i moshës madhore në atë afat nuk kryen vepër penale të re që është parapar me ligj si vepër penale. Të dhënat për gjykim me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur fshihen nga evidenca pas një viti kalimi i kohës për kontroll, nëse fëmiu ose personi më i ri i moshës madhore në atë afat nuk kryen vepër të re që është parapar me ligj si vepër penale. Të dhënat për masat e shqiptuara nga enti, dënimi në para si dhe masat alternative fshihen nga evidenca kur do të kalojë një vit nga zbatimi ose parashkrimi i tyre, nëse fëmiu ose personi më i ri i moshës madhore në atë afat nuk kryen veprim të ri që është paraparë me ligj si vepër penale ose kundërvajtje. Të dhënat për dënimin e shqiptuar më burg për fëmijë fshihen nga evidence kur do të kalojnë pesë vite nga dita e dënimit të mbajtur të parashkruar ose të falur, nëse në atë afat fëmiju ose personi i ri i moshës

⁴⁵ Poaty, fq. 505

⁴⁶ Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V-së, nr. 148/2013, neni 72 p.4

madhore nuk kryen vepër tjetër që me ligj është paraparë si vepër penale. Kur plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafët 1 deri në 4 të këtij neni, të dhënat për sanksionet e shqiptuara fshihen nga evidenca, kurse të gjitha dokumentet asgjësohen me fuqi ligjore.⁴⁷

Dënimi me burg për fëmijë nuk mund të zbatohet kur do të kalojnë:

- Dhjetë vite nga gjykimi me burg për fëmijë mbi pesë vjet;
- Pesë vite nga gjykimi me burg për fëmijë mbi tre vjet;
- Tre vite nga gjykimi me burg për fëmijë deri në tre vjet.

Parashkrimi i zbatimit të dënimit në para krijohet kur të kalojnë dy vite nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është shqiptuar ai dënim. Parashkrimi i zbatimit të dënimeve për ndalim të drejtimit të automjetit motorik dhe dëbitmit të të huajit nga vendi, krijohet kur do të kalojë koha për të cilën janë shqiptuar ato dënime, e nëse dëbimi është shqiptuar përgjithmonë, kur do të kalojnë pesë vjet nga shqiptimi i tij. Parashkrimi i zbatimit të masës alternative për punë me dobi të përgjithshme, masave të sigurisë dhe sanksioneve kundërvajtëse, krijohet kur do të kalojë një vit nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin ato janë shqiptuar. Parashkrimi i zbatimit të masës edukuese nga entet, dërgimi në shtëpi edukuese përmirësuese, krijohet kur do të kalojnë pesë vjet nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është shqiptuar ajo masë edukuese. Parashkrimi i zbatimit të masës së entit për dërgimin e fëmijës në institucion edukues dhe të masave të mbikëqyrjes së përforcuar, krijohet kur do të kalojnë tri vite nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin janë shqiptuar ato masa edukuese. Parashkrimi i zbatimit të masës disiplinore edukuese dërgimi në qendër për fëmijë, krijohet kur do të kalojnë gjashtë muaj nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është shqiptuar kjo masë edukuese⁴⁸.

⁴⁷ Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R.M.V-së, nr. 148/2013, neni 73 p. 1 2 3 4 dhe 5

⁴⁸ Po aty, neni 74

Kapitulli II

2. EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME BURGIM PËR FËMIJË DHE TRETMANI I FËMIJËVE TË BURGOSUR

Në Republikën e Maqedonisë të Veriut në gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar është formuar sektori i specializuar për kriminalitetin e të miturve i përbërë nga: Gjykatësi për të mitur, këshilltarët për të mitur, dhe këshillat për të mitur. Këshillat për të mitur në gjykatën themelore përbëhen nga gjykatës për të mitur dhe gjykatës porotë, ku gjykatësi për të mitur është edhe kryetari i këshillit. Gjykatësit porotë zgjidhen ngaradhët e punonjësve të arsimit-psikologëve, sociologëve dhe personave të tjerë të cilët kanë përvojnë në edukimin dhe arsimimin e të rinjve. Këshilli për të mitur në gjykatën themelore vendos në shkallë të parë në procedurën për veprat penale si dhe për ankesat kundër vendimeve të gjykatësit për të mitur dhe në raste të tjera të parashikuara me këtë ligj. Ndërsa, këshillat për të mitur të gjykatës së Apelit i përbërë nga gjykatësi për të mitur dhe dy gjykatës, vendos për ankesat kundër vendimeve të këshillit për të mitur të gjykatës themelore, si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj.⁴⁹

Gjykata mund të shqiptojë dënim me burg ndaj kryerësit i cili ka mbushur moshëm 16 vjeçare dhe ka kryer vepër për të cilin është parapar dënim me burg sipas lgjit për drejtësin e fëmiut në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi ndaj ekzekutimit të dënimit me burgim për fëmijë është që të kontribuohet në rehabilitimin dhe riedukimin e fëmijut dhe me aftësimin e tij profesional, poashtu ky dënim duhet të ndikoj pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recedivizmin. Burgimi i fëmiut mbahet në institucione korektuese për fëmij. Personat e mitur të cilët e mbajnë dënimim me burg për fëmijë gjatë qëndrimit në institucion ka të drejta dhe obligime si dhe personi madhori i dënuar me burgim. Stafi profesional apo personeli që trajtojnë fëmijun kërkohet që të jenë të aftësuar dhe disponojnë

⁴⁹ Ligji mbi drejtësinë për të mitur, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.87/2007, neni 44,

me njohuri nga lëmia e pedagogjisë, sociologjisë, penologjisë dhe lëmive të tjera. Institucionet korrektuese ku mbahen dënimi për fëmijë është i llojit gjysëm të mbullur, përjashtimisht fëmiu mund të mbajë dënim me burg edhe në institucione korrektuese të tipit të mbyllur. Meshkujt dhe femrat mbajnë dënimin me burg për fëmijë të ndarë në institucione të veçanta korrektuese apo pavione brenda këtij institucioni. Parimisht fëmiu e mban dënimin me burg së bashku mirëpo drejtori i institucionit të burgut për fëmijë mund të lejoj që i mituri të ndahet nga personat e tjerë të dënuar me kërkesën e tij gjatë mbajtjes së dënimit. Drejtori mund të urdhëroj fëmion që të ndahen nga personat e dënuar edhe pa kërkesën e tij nëse vlerësohet se ajo masë është e nevojshme e vecmas kur vlerësohet se ka për qëllim parandalimin e rrezikut për shëndet apo për jetë të fëmijut ose kur parandalohet kërcënimi ndaj sigurisë së institucionit korrektues. Fëmiu i cili është duke mbajtur dënimin ka të drejtë pushimi vjetor nga dy herë cdo vit, pushimi zgjat deri në 30 ditë dhe sipas rregullit lejohet kur i mituri nuk e vijon procesin mësimor, gjithashtu shërbimi sprovues kujdeset për krijimin e kushteve për punësim, vijimin e shkollimit, trajtim mjekësor, rregullimin e rrethanave familjare dhe çështjeve tjera që janë me interes për të miturin⁵⁰.

2.1 Procesi i riedukimit dhe riintegrit

Me termin riedukim nënkuptojmë edukim të sërishëm, çka nënkuptojmë se duhet të edukohet një person që nuk e ka marrë edukatën e mirëfillt, apo ka marrë edukatë të gabuar që nuk është në pajtueshmëri me ligjin, rregullat, parimet e një legjislacioni të caktuar, pra me nocionin riedukim dhe riintegrim duhet të kuptojmë gjendje të personit i cili është i dënuar dhe gjatë qëndrimit në ent në bazë të tretmaneve të caktuara duhet të ndyshojë esencialisht.

Personi i dënuar sipas sistemit modern, nuk dënohet pse ka gabuar por ai i nënshkrohet procesit të punës riedukative, që në të ardhmen të mos gabojë, gjatë qëndrimit në institucion korrektues, përgaditet që në të ardhmen të sillet në pajtim me normat shoqërore morale dhe ligjore të ambientit ku duhet të jetojë dhe punojë. Sistemi modern i ekzekutimit të dënimit me burg gjendet në një proces permanent të ndërtimit dhe përsosjes së tij.

⁵⁰ Halili R. 2014, Penologjia, Prishtinë, fq. 271-273

Në këtë drejtim kontribut të veçantë kanë dhënë Rregullat standarde minimale të OKB-së për trajtimin e personave të burgosur, Rregullat Evropiane të burgut, Konventat Evropiane mbi ndalimin e torturës, trajtimit dhe dënimit johuman dhe degradues dhe akte të tjera. Në këtë drejtim, me trajtime teorike dhe kërkimet empirike, veçmas bëhen përpjekje për gjetjen dhe nërtimin e metodave dhe mjeteve më të përshtatshme për arritjen e qëllimit të riintegritit dhe riedukimi të personave të dënur⁵¹.

Procesi i riedukimit dhe riintegritit zhvillohet në institucionet korrektuese ku personeli i burgut mban përgjegjësi për shërbimet e ndryshme në institucion, që një person të përsëri të riedukohet dhe risocializohet dhe riintegrohet në shoqëri, që në të ardhmen të silltet në mënyre të drejtë në harmoni me ligjin, duke iu përshtatur rregullave dhe normave.

Me anë të riedukimit dhe riintegritit kërkohet një ndryshim rrënjësor ku fëmiju duhet të pësojë transformim si në sjellje ashtu edhe në bindjet e tij lidhur me veprën që e ka kryer, dhe sjellja e tij të ndryshojë jo nga frika dhe kërcënimi i ndëshimit por nga bindja dhe vetë zgjidhja e tij se kjo mënyrë është më e mira në interes të jetës dhe mirëqenies së tij.

Në procesin e riintegritit të personave të dënur, me rëndësi është që personi i dënur të riedukohet në atë shkallë sa ai ti aprovojë vlerat dhe normat shoqërore, ti respektojë ato dhe ti konsiderojë si obligime që janë në të mirë të tij.

Me proces të riintegritit nënkuptojt edhe krijimi i një vetëdije të të dënuarit mbi nevojën e respektimit dhe zbatimit të disa rregullave dhe normave në ambientin e caktuar shoqëror.

Gjatë procesit ai duhet të riedukimit dhe riintegriti ai duhet të bindet se problemet, mos marrëveshjet dhe konfliktet e tij në shoqëri nuk vijnë vetëm nga mjedisi që e rrethon por shpesh janë produkt i gjendjes psikike dhe shpirtërore të personalitetit të tij.

Gjatë qëndrimit në ent ai duhet që duke iu nënshtruar procesit të tretmanit të arrijë që ti harmonizojë kërkesat motivet dhe dëshirat e tij personale me raportet e mjedisit me normat dhe rregullat ligjore që vlejné në shoqëri. Nëse arihet që personi i dënur ti kuptojë këto veti ti

⁵¹ Po aty, fq. 145

pranojë atëherë ekziston shans më i madh që procesi i riedukimit dhe riintegrit të jetë më i suksesshëm.

Në këtë mënyrë gjasat për përsëritjen e sjelljeve kriminale të të dënuarit janë shumë të vogla. Me qëllim të riintegrit të plotë të personave të dënuar sistemi modern i ekzekutimit të dënimit me burgim në pajtim me rregullat standarde minimale të OKB-së dhe me idenë e shkollave dhe lëvizjeve humanitare, është i interesuar që të krijojë disa parakushte themelore në këtë drejtim. Ato parakushte kanë të bëjnë me organizmin e një tretmani më adekuat të riintegrit të personave të dënuar. Ai është i mudnshëm vetëm nëse bëhet studimi dhe observimi i personalitetit të personit të dënuarit, individualizimit i traktimit të të dënuarit, klasifikimi i të dënuarve, klasifikimi i institucioneve korrektuese dhe nëse zbatohet në mënyrë permanente ndihma psotpenae ndaj personave të dënuar⁵².

Pra procesi i riedukimit dhe riintegrit arihet me një angazhim të veprimeve edukuese të personave të dënuar, angazhim për punë të tyre, angazhim në aktiviteti për aftësimin e tyre profesional, këto janë veprime të cilat miren gjatë kohës kur fëmiu gjendet në institucione korrektuese me qëllim që të mënjanoen shprehite dhe sjelljet negative me të cilat ka ardhur në ent dhe gjendja e tij të ndryshohet në drejtim pozitiv. Nga kjo pjesë ku sqaruam disa pika të procesit dhe rëndësia e riedukimit dhe riintegrit të fëmijëve, mund të konstatoj se institucionet edukuese, shtëpitë edukuese, entet, burgjet nuk mund të japin garancion për një edukim apo riedukim të plotë dhe riintegrit të sigurt të fëmiut në shoqëri.

Ky proces nuk duhet të ndaloj së vepruari edhe pse fëmiu do ti përmbush të gjitha normat e parapara me ligj dhe do të bind të gjithë përgjegjësit e institucionit korrektues me sjelljet dhe veprimet e tij se veprimi për të cilin ka qenë në institucion korrektues nuk është i mirë për të ardhmen e tij dhe shoqërinë, që procesi të jetë i suksesshëm unë mendoj se është e patjetërsueshme angazhimi i rethit familjar me një bashkëpunim brenda familjar në fillim dhe pastaj me institucione të caktuara të cilat do të kontribonin që këta fëmijë të vazhdojnë jetën normale dhe zhvillim normal, si institucione të cilat do të duhej të kontribonin në këtë drejtim rëndësi të veçantë do i jepja sektorit të policisë së shtetit dhe shkollave, duke instaluar një

⁵² Halili R. 2014, Penologjia, Prishtinë, fq. 147

sistem apo program të caktuar dhe angazhim të veçantë rreth këtyre çështjeve, por duke mos anashkaluar as institucionet tjera shtetërore, qëllimi i këtyre institucioneve të jetë që tëndikojnë drejtëpërdrejt në evitimin e përsëritjes së veprave të ndaluara sipas ligjit, gjithashtu si një mënyrë veprimi mund të jetë që organet policore të infiltrohen në rrethin e tyre shoqëror dhe të testojnë fëmijët se sa janë të gatshëm për përsëritjen e veprime të caktuara. Ndërsa për fëmijët të cilët janë të lënë jashtë rrethit familjar duhet krijuar institucion i veçantë që do të kujdeset me fëmijët deri në një moshë të caktuar që të luajë rolin e familjes që ata të mos përsërisin veprime të ndaluara, i njëjti angazhim i institucioneve shtetërore duhet të jetë për të gjithë fëmijët.

2.2 Individualizimi i tretmanit penitenciar si kusht për riedukim të fëmijëve

Me individualizim të tretmanit penitenciar të personave të dënuar nënkuptohet përshtatja e metodave dhe mjeteve të ndikimit të personalitetit të tyre. Kjo do të thotë se mjetet, metodat, masat e veprimeve të cilat ndërmiren nga ana e personelit të institucionit ose institucionit duhet të përshtaten vetive dhe cilësive psikike, sociale dhe kulturore të personave të dënuar. Është e ditur se të gjitha masa dhe metodat e tretmanit nuk ndikojnë njësoj te të gjithë fëmijët e dënuar, disa masa dhe metoda kanë efekte dhe ndikim më të vogël, në disa raste, disa masa dhe metoda që aplikohen, nëse nuk u janë përshtatur vetive të personalitetit të të dënuarit, mund të sjellin edhe efekte negative. Për këtë arsye, individualizimi i masave, mjeteve dhe metodave të tretmanit të personave të dënuar është parakusht “*conditio sine qua non*”, si thekson një autor, për riedukimin dhe riintegrimin e suksesshëm. Për t’u realizuar dhe zbatuar me sukses individualizimi i tretmanit ndaj personave të dënuar, është e domosdoshme që të ndërmiren disa veprime dhe masa konkrete nga ana e personelit të institucioneve korrektuese, këto masa kanë të bëjnë me studimin, observimin dhe njohjen e personalitetit të të dënuarit.⁵³

Analizimi i tipareve që e karakterizojnë fëmijën e dënuar dhe tretmanin që do të zhvillohet në bazë të kësaj analize do të jetë më i efektshëm pasi do të tentohet që masat që do të ndërmerren të përshatën personalitetin e tij.

⁵³ Halili R. 2014, Penologjia, Prishtinë, fq. 150

Është shumë i rëndësishëm që të ndryshohet personaliteti i fëmiut pasi nëse do të zhvillohej një tretman joadekuad qëndrimet, sjelljet, pikëpamjet të cilat e kanë shtyrë fëmiun të kryej vepër penale është e pamundur të ndryshohen, nga ky definicion kuptojmë se tretmani i individualizuar është njëri ndër proceset më të rëndësishme për riedukimin e fëmiut.

Tretmani i individualizuar nënkupton se tretmani duhet të kalojë nga faza e parë e cila është duke filluar me njohjen e fëmiut të dënuar, njohjes së vetive dhe cilësive të tij elementare deri te njohja më e thell e qëndrimeve, pikëpamjeve dhe vetive të karakterit të tij. Tretmani i individualizuar ka për qëllim ndryshim pozitiv të fëmiu duke aritur të realizojnë me sukses riedukimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

2.3 Institucioni korrektues për ekzekutim të dënimit me burgim për fëmijë në RMV- Burgu për fëmijë në Ohër

Ky institucion ndëshkues-korrektues- Ohër është i pozicionuar në afërsi të Stacionit policor Ohër, i rethuar me objekte private për banim dhe objekte afariste. Pjesa në të cilën janë të vendosur fëmijët të cilët vuajnë masën e entit ëshë në objektin ku janë të vendosur edhe personat e dënuar me dënim me burg për të mitur, në rast fëmijët e entit edukues-korrektues janë vendosur në katin e parë në pjesën e përparme të institucionit, e cila është e ndarë nga pjesa e burgut vetëm me një derë, obori i institucionit ndëshkues-korrektues është i ndarë në dy pjesë me rrjetë të metaltë, një pjesë e oborrit është për fëmijët e Entit edukues korrektues, ndërsa pjesa tjetër për fëmijët e burgut, oborrit e shfrytëzojnë për aktivitete sportive, lëvizje në ajër të pastër dhe i njëjti mund të shfrytëzohet vetëm në kushte të volitshme atmosferike, pasi është nën qiell të hapur, përkatësisht nuk është i mbuluar, edhe pse sipas autoriteteve të këtij institucioni bëhen përpjekje që fëmijët të ndahen nga personat e tjerë, nga inspektimi dhe biseda me fëmijët u konstatua se komunikimi dhe kontakti ndërmjet fëmijëve dhe personave të dënuar nuk mund të pengohet në tërësi, nga ana tjetër lokaliteti i këtij institucioni ndëshkues-korrektues, (në afërsi të qendrës së qytetit), ndërkaj në këtë kontekst edhe të pjesës ku janë vendosur fëmijët mund të vënë në pyetje funksionin e procesit riedukues, nëmes tjerash edhe për shkak të tentimit për ikje, për shkak se vetë muret e burgut i ndajnë fëmijët nga bota e jashtme, përkatësisht nga lëvizja e lirë, çështje tjetër është se sa në kushte të këtu është e

mbrojtur privatësia e fëmijëve, kur nga objektet e afërta mundet lehtë të shihet lëvizja e tyre rreshtimi gjatë ditës, të shkuarit në kuzhinë, shfjrtëzimi i kohës së lirë dhe kjo gjë ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejt ndaj dinjitetit të tyre, sidomos nëse meret parasysh mosha në të cilën gjendet dhe faza e ndjeshme e zhvillimit të tyre psiko-fizik, enti edukues korrektues ka kapacitet për vendojsen e rreth 35 fëmijëve.⁵⁴



Obori i institucionit për fëmijët e entit edukues korrektues - Ohër

⁵⁴<http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>

Kapitulli III

1. MJETET DHE METODAT E TRETMANIT TË FËMIJËVE TË DËNUAR ME BURGIM

Mjetet dhe metodat që përdoren për tretman të fëmijëve të dënuar kanë për qëllim arritjen sa më efikase të qëllimit me burgim, realizimin e procesit të riedukimit, risocializimit dhe riintegritit të personave të dënuar. Mjetet dhe metodat për tretman përdoren nëpër institucione korrektuese dhe edukative përmisuese, ku nëpërmjet formave të ndryshme tentohet arritja e rezultateve sa më të mira në procesin e riedukimit dhe riintegritit të fëmijut. Mjetet dhe metodat janë proces i paramenduar që më parë për aritjen e rezultateve sa më të mira të fëmijët.

Egzistenca e mjeteve dhe metodave të tretmanit të fëmijëve është në pajtueshmëri me parimet themelore të përfshira në rregullat Evropjane për të drejtat e fëmijëve të cilët kanë kryer veprë penale. Mjetet dhe metodat e tretmanit mund të shqiptohen fëmijut i cili ka kryer veprë që me ligj përcaktohet si veprë penale, për mjetet dhe metodat e tretmanit të fëmijëve të dënuar do të meret parasysh mosha e fëmijut, shkalla e zhvillimit të tij shpirtëror, vetitë e tij psikike, arsimi i deritanishëm, arsyet që e kanë shtyrë të kryej veprën, rethi ku ka jetuar, pesha e kryerjes së veprës, nëse kundër fëmijut ndonjëher është ushtruar ndonjë tretman i caktuar⁵⁵.

Për fat të keq në vendin tonë mjetet dhe metodat për tretmanin e fëmijëve nuk janë në nivelin e duhur, duke filluar nga mungesa e edukatorëve, mjekut, mungesa e hapsirave zbavitëse dhe sportive, për të cilat do të sqarojmë gjatë pikave në vijim, duke u ndalur në secilin mjet dhe metodë që me dispozita ligjore duhet të ketë secili ent që ka për funksion riedukimin dhe riintegritin e fëmijëve në shoqëri.

Mjetet dhe metodat për tretmanin e fëmijëve të dënuar janë⁵⁶:

- Puna e fëmijëve të dënuar;
- Puna e edukatorit;

⁵⁵ Recommendation CM/Rec (2008)11 of the Committee of Ministers to member states on the European Rules for juvenile offenders subject to sanctions and measures, 5.11A.2008, Council of Europe

⁵⁶ Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 176

- Puna e psikologut;
- Puna e mjekut;
- Arsimimi i fëmijëve të dënuar;
- aktivitet zbavitëse dhe sportive;
- Të drejtat dhe obligimet e fëmijëve sipas rendit shtëpiak në objektin e burgut për fëmijë.

3.1 Puna e fëmijëve të dënuar

Një ndër metodat më të fuqishme për realizmin e procesit të riintegritit konsiderohet puna dhe angazhimi i fëmiut në burg, qëllimi dhe karakteri i punës ka qenë i llojllojshëm, gjithmonë ka qenë i varur dhe i bazuar në dënimin që e ka pasur fëmiu.

Puna paraqitet si mjet pozitiv për përmirësimin e fëmiut ajo është e detyrueshme atëher kur personeli i burgut do ta shoh si të arsyeshme, puna është proces që rjedh nëpër faza të ndryshme të fëmiut, ku në fillim nuk pritet ndryshim i madh apo rënjësor i karakterit të tij, mirëpo me kalimin në kohës edhe natyra e punës do të ndryshojë ku nëpërmjet këtij trajtimi, mjeti dhe metode do të tentohet një tretman i sukseshëm dhe pozitiv.

Puna në fillim ka karakter shterngues që me kalimin e kohës ndryshon qasje dhe fillon të transformohet në mjet nëpërmjet të cilit do të bëhet përpjekje fëmiu të aftësohet për jetën në të ardhmen. Karakteristikë e punës të fëmiut është që të krijohen shprehje për punë, për krijimin e bindjeve dhe shprehje të reja për ndryshimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të mëparshme të fëmiut të dënuar⁵⁷.

Tretmani nëpërmjet punës konsiderohet edhe si misioni për ti bindur fëmijët se me punë të ndershme mund të sigurohet jetë e pavarur dhe dinjitoze në shoqëri, qëllimi i këtij trtmani është që fëmijët të aftësohen me përfitimin e zantave, mjeshteri dhe profesione të ndryshme të cilat pa pengesa mund të garantojnë vazhdimin e jetës dhe ekzistencës në liri, në një formë sigurohet effzistenca materiale dhe sociale, kur të dalin nga institucionet korektuese.

⁵⁷ Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 177

Puna mund të jetë edhe e karakterit të dobishëm në ekonominë shtetërore apo shoqërore, në aspektin etik dhe social duhet të jetë punë që bëhet në liri. Në fillim e cekëm që puna do kalojë nëpër disa faza ku lloji i punës do të jetë në bazë të karakteristikave të personalitetit të fëmiut dhe llojit të dënimit që ka, duke u bazuar në këtë teori do ti jepet hapësirë fëmiut që të shprehë dëshirën e tij për llojin e punës, ku do të shiqohen aftësitë e tij për punë të caktuar, mundësitë dhe angazhimin e tij⁵⁸.

Puna e fëmiut është e drejtë e tyre që garantohet me Deklaratën e përgjithshme mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, për arsye se e drejta e punës është e drejtë elementare njëzëore që njeriut i siguron ekzistencën dhe për këtë arsye nuk duhet ti mohohet askujt e as personave të dënuar e në këtë rast fëmijëve.

Nëpërmjet punës institucioni korrektues angazhohet që të bëjë ngritje profesionale të fëmijëve dhe përgaditje që pa vështirësi të vazhdojë jetën në liri, kështu edhe qëllimi i kësaj metode dhe këtij mjeti të punës për fëmijë sipas sistemit modern dhe bashkëkohor. Arsimimi dhe përgatitja profesionale planifikohet dhe programohet me kycjen e ekspertëve të profesioneve të ndryshme, fëmijët e dënuar që do të ndjekin punë në profesione të caktuara në përfundim të këtij programi do të paisen me certifikata, diploma, dëftesa dhe dëshmi tjera që do të vertetojnë aftësinë e tyre për punë dhe që do të pranohen pa problem në liri, pas përfundimit të dënimit.

Institucioni korrektues është i detyruar që të gjithë fëmijëve të mundësojë kushte të njejta për punë, mbrojtje në punë, dhe të mundësojë krijimin e të gjitha kushteve që do të ishin të pranishme sikur fëmiu të ishte në liri, puna nuk ka për qëllim fitimet materiale por qëllimi i kësaj metode është aftësimi profesional për jetë të pavarur në liri⁵⁹.

⁵⁸ Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 177

⁵⁹ Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 177

3.2 Puna e edukatorit

Një ndër metodat më të rëndësishme të tretmanit në burg është puna e eduktorit, puna e edukatorit është e komplikuar e cila përfshin një punë me aktivitete të shumta dhe procese të ndryshme në raport me të dënuarin. Puna e edukatorit lidhet me nevojën e njohjes së plotë të personalitetit të të dënuarit me përcjelljen e punës dhe sjelljeve të tij në tërësi, bisedat, këshillimet, arsimimin dhe orientimin personal, pra puna e edukatorit qëndron në shumë veprime dhe aktivitete të planifikuara dhe të programuara që më parë⁶⁰.

Puna e edukatorit bazohet në njohuritë që ka edukatori për personalitetin e të dënuarit, për njohjen e personalitetit të tij, me njohjen e dokumentacionit të plotë nga gjykata lidhur me veprën penale, me qëllim që të studiojë dosjen dhe dokumentacionin penologjik të të dënuarit, të analizojë sjelljet dhe qëndrimet që fëmiu i ka pasur, të dhëna mbi familjen e tij, të dhëna mbi aktivitetet që i ka kryer në liri si dhe vlersime dhe konstatime të tjera për vetitë subjektive dhe individuale të personalitetit të tij. Edukatori nëpërmjet aktiviteteve të kryera që u potencuan më lartë duhet që të arrijë të përcaktojë dhe konkretizoj gjendjen psikike dhe shpirtërore të fëmiut, nëpërmjet këtyre përcaktimeve ai do të veprojë në mënyrën më të mirë të mundshme që të arrijë në mënyrë sa më efektive riedukimin dhe riintegrimin e fëmiut të dënuar.

Shumë ente nuk kanë qendra për studim dhe observim të personave të dënuar, nuk kanë kuadër të aftë për hartimin e programeve të tretmanit dhe kështu, shpeshherë, kërkesat e tilla mund të shtrohen vetëm si kërkesa teorike, po ashtu shpeshherë, ndodh që raporti në mes edukatorit dhe numrit të personave të dënuar të jetë në disproporcion, në disa ente, në të cilat janë grumbulluar një numër i madh i personave të dënuar e nga ana tjetër ka pak edukatorë dhe pedagogë të punësuar, puna e edukatorëve dhe pedagogëve është e kufizuar, sepse atyre për një edukator vjen një numër i madh personash të dënuar, cka e vështirëson mundësinë e punës të suksesshme individuale të edukatorit apo pedagogut⁶¹.

⁶⁰ Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 177

⁶¹ S. Surbatovic etj, Individualni rad vaspitaca osudjenim licima, Penoloski Flasniki, nr.6-7, 1985, fq. 44-45

Rruga drejt riedukimi dhe riintegrit të fëmiut të dënuar është nëpërmjet edukatorit, pasi fëmiu do të udhëhiqet dhe do të orientohe në atë rrugë nëpërmjet punës së edukatorit, nëpërmjet kontakteve me edukatorin fëmiu do të arrijë të finalizojë me sukses riintegrimin, ndryshimin e sjelljeve dhe qëndrimeve, krijimin e shprehive të reja pozitive, të cilat do të shfrytëzojë në liri.

Rëndësi të madhe ka mënyra se si do të bëhet njohja dhe vazhdimi i kontaktit të edukatorit me fëmiun e dënuar, në këto raste edukatori duhet të ketë kujdes të vecantë që të arrijë të komunikojë me fëmiun në mënyra të ndryshme që të fitohet besimi te fëmiu se edukatori është njeriu me të cilin mund të shoqërohet në ent, të fillojë të shpreh mendimet e veta lirshëm, që nëpërmjet të dhënave që do të krijohen të arihet procesi i riintegrit.

Puna e edukatorit llogaritet si mjeshtëri e vecantë me anë të së cilës do të bind fëmiun se ai është personi i cili po kujdeset për ti ndihmuar atij, pasi që fëmiët janë të rezervuar ndaj cdo të punësuarit në ent dhe nuk pranojnë çfardo kontakti me personelin e entit, është edukatori ai i cili duhet të ndryshojë këtë gjendje që të hapë botën psikike dhe shpirtërore të fëmiut, hapat drejt aritjes pozitive të procesit të tretmanit të fëmijëve në ent fillojnë nga edukatori i cili nëse do të arrijë të vendojë kontaktet e para të shëndosha të krijojë një besim reciprok atëherë tretmani do të jetë më i suksesshëm, në këto raste kur krijohet besim nga ana e fëmiut ata vetë kërkojnë biseda me edukatorët e cila paraqet shenjë që procesi është në rrugën e duhur.

Disa nga metodat që përdorin edukatorët me fëmijët e dënuar janë⁶²:

- metoda e bindjes;
- metoda e krijimit të shprehive;
- metoda e nxitjes;
- metoda e premtimit, dhuratave dhe shpërblimeve;
- metoda e shterngimit dhe ndëshkimit;

⁶² Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 178

Metoda e bindjes – qëndron në aktivitetin e edukatorit dhe punëtorëve të tjerë penitensiarë që personat e dënuar ti bindin për sjelljet, qëndrimet dhe veprimet e ndryshme që janë të dëmshme dhe negative për pozitën e tyre dhe shtrojnë nevojën qëai, këto veprime dhe sjellje, duhet ti ndryshojë në kahje tjetër, kjo metodë, vecmas ka të bëjë me insistimin e edukatorit që ti bindë të dënuarit ti respektojnë rregullat e rendit shtëpiak, obligimet dhe detyrimet tjera të cilat parashtrihen para tyre gjatë qëndrimit në ent, të bindësh personat e dënuar, do të thotë të bësh përpjekje permanente dhe biseda të përditshme me qëllim të krijimit të një gjykimi tjetër, një vlerësim të ri, një raport fare tjetër lidhur me disa vlera dhe të mira të caktuara, bindja arrihet me anë të shpjegimit të drejtë dhe objektiv të ecurive dhe raporteve që janë në interes të përmirësimit të personave të dënuar, edukatori dhe pedagogu, personave të dënuar u ofrojnë shpjegime konkrete lidhur me atë se çka është e mirë, çka është e vlefshme, çka është e drejtë dhe e favorshme për pozitën e tyre në ent, përvec shpjegimit, për krijimin e bindjes, rol me rëndësi në këtë drejtim luan edhe paraqitje e shembujve konkretë nga jeta e përditshme, si brenda në ent, ashtu edhe jashtë institucionit, këta shembuj të cilët u prezantohen personave të dënuar, mund të jenë me karakter dhe domethënie pozitive por edhe negative, është me rëndësi që gjatë paraqitjes dhe perzantimit të shembujve personat e dënuar të kenë mundësi të zgjedhin vetë dhe të deklarojnë se cilët shembuj janë me tipare naegativë e cilët të favorshëm.⁶³

Metodat e krijimit të shprehive – te fëmijët e dënuar qëllim kryesor është krijimi i shprehive pozitive, që të arrijmë që te fëmijët të instalojmë krijimin e shprehive të caktuara pozitive duhet që vazhdimisht ti përsërisim ato në ent, si shprehi të cilat tentohet të mësohen dhe aftësohen në ent janë që fëmiu të mësohet të kryejë aktivitete në të mirë të shoqërisë dhe në këtë mënyrë të çrrënjosen aktivitetet dhe shprehitë e mëparshme negative, shprehitë për higjienë personale, për higjienë të ambientit, për aftësim profesional për mirësjellje dhe qëndrim korrekt ndaj të tjerëve etj.

⁶³ A.Sobotincic: Uloga pojedinih kategorija radnika u KPD u odgojnom procesu resocijalizacije, botuar në Penlogjia, nr 1.197, fq. 4-5

Metoda e nxitjes – qëllimi i kësaj metode është që të nxitë fëmijun të zhvillojë aktivitete të caktuara pozitive, të zgjojë motive, vullnet, dëshira për veprime pozitive, metoda e nxitjes vjen në shprehje më së shpeshti tek fëmijët të cilët janë më pasiv, pa vullnet dhe të paiterësuar, mënyrat të cilat përdoren për nxitje janë: premtimet të ndryshme, lëvdatat, dhurata, notimi etj.

Metoda e premtimit, dhuratave dhe shpërblimeve në mënyrë publike –është një metodë me anë të së cilës do të nxiten aktivitetet të dobishme për fëmijët, mirëpo përdorimi i kësaj metode duhet të jetë me kujdes të madh që të mos shkojë në skajshmëri që të mos shkaktohen paknaqësi në mes të fëmijëve, xheloz, urejtje, egoizëm, agresivitet, mostolerancë etj.

Metoda e shtërngimit dhe ndëshkimit –aplikohet nga ana edukatorit dhe pedagogut kjo metodë vjen në shprehje në rastet kur metodat tjera nuk janë efektive, këto metoda ndërmiren ndaj fëmijëve të cilët nuk janë të ndërgjegjshëm, nuk respektojnë rregullat e entit etj. Qëllimi i kësaj mase është që fëmijët të kuptojnë se sjellje të caktuara nuk janë të mira dhe janë në dëm të tyre dhe shoqërisë. Si mjete që përdoren për këtë metodë janë: qortimi, vërejtja, kontrolli, mbikëqyrja, ndalesa të ndryshme, detyrim për kryerje të veprimeve të caktuara.

3.3 Puna e psikologut

Psikologu luan rol të rëndësishëm për tretmanin e fëmijëve, ai bën klasifikimin e tyre në grupe dhe nëngrupe duke u bazuar në karakteret e tyre, ai u ndihmon fëmijëve që të përshtaten në ambientin korrektues, si punë dhe veprime që i përdor psikologu lidhur me tretmanin e fëmijëve janë: zbatimi i testeve të ndryshme, intervistave, bisedave etj. Fëmijët zakonisht nuk janë të gatshëm që të i përgjigjen kërkesave të psikologut si testet, intervistat dhe bisedat e ndryshme, mirëpo si detyrë e psikologut është që ti bindë ata se këto veprime janë për të mirën e tyre dhe kanë për qëllim që ti ndihmojnë ata dhe jo tu shkaktojnë të këqija apo ti dëmtojnë. Sipas koncepteve penologjike bashkëkohore, në teorinë penologjike, megjithë vështirësitë e caktuara, psikologu ka rëndësi dhe ndikim të madh në procesin e riintegrit të personave të dënuar, me njohuritë dhe angazhimin e vet profesional, ai ndihmon shumë të dënuarit që ti

përshtaten jetës dhe punës në mjedisin korrektues, psikologu ka për detyrë që të ndikojë edhe në personelin e institucioni që ai të kycet në tretmanin bashkëkohor të personave të dënuar⁶⁴.

3.4 Puna e mjekut

Mjeku është specialist i cili kujdeset për fëmijët në ent, pozita e mjekut ka rol të rëndësishëm në tretmanin e fëmijëve për shkak se konsiderohet se fëmijët e burgosur kanë besim të madh te mjeku, gjë që mundëson krijimin e kontakteve më të afërta me fëmijët e dënuar, situata e cila shfytëzohet nga mjekët që të ndikojë pozitivisht dhe të krijohet mundsi për ndikim pozitiv në sjellejt dhe qëndrimet e tyre në ent. Nga afërsia që në bazë të praktiës krijohet në mes mjekut dhe fëmijëve është shumë e shpeshtë që fëmijët të rëfelen për çështje të ndryshme, probleme që pjesa tjetër e personelit të burgut nuk i dinë.



Ambulanca ku kontrollohen fëmijët –Institucioni për fëmijët e entit edukues korrektues Ohër⁶⁵

Shpenzimet të cilat paraqiten nga shërbimet shëndetësore që do të bëhen fëmijëve janë shpenzime të cilat mbulohen nga Enti korrektues.

Enti është i obliguar që të mbajë dosje personale shëndetësore për të gjithë fëmijët të vendosur në ent dosje të cilat duhet të ruhen dhe të udhëhiqen me lista për evidenca ku do të jenë të evidentuar gjendjet shëndetësore të fëmijëve poashtu do të shënohet të gjitha intervenimet që

⁶⁴ Halili R. 2014, Penologji, Prishtinë, fq. 184

⁶⁵ <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>

do të ndërmieren për shëndetin e fëmijut, medikamentet që shfrytëzohen në institucion duhet të jenë në vend të sigurt.

Në entin edukues korrektues në Ohër nuk ka mjek i cili gjendet në hapësirat e parapara dhe sipas ligjit, duke pasur parasysh rëndësinë e mjekut në procesin e risocializimit si një nga metodat më të suksesshme të afrimit me fëmijë dhe krijimin e besimit mes tyre, në vendin tonë kjo metodë nuk respektohet ashtu si është paraparë me ligj.



Hapsira ku ruhen medikamentet ne institucionin për fëmijët e entit edukues korrektues - Ohër⁶⁶

Personave të gjykuar dhe të paraburgosur duhet që të ju sigurohet ndihmë e nevojshme mjekësore, sipas rregullave nga fusha e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor⁶⁷.

Punonjësit shëndetësor, të punësuarit në institucionet shëndetësore publike, që kryejnë mbrojtjen primare shëndetësore në rrjetin e institucioneve shëndetësore, që në zonën në të cilin gjendet qendra e institucionit, japin shërbime shëndetësore personave të gjykar dhe të paraburgosur, shpenzimet për mbrojtjen shëndetësore të këtyre personave në institucion bien në barë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë⁶⁸.

⁶⁶ <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>

⁶⁷ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e RM-së nr. 170/30, neni 20

⁶⁸ Poaty, neni 20 paragrafi 2

Mjekët duhët të jenë të vetëdishëm për rethanat të cilat krijohen nga raporti i tyre i afërt me fëmijët dhe të njejtat duhet ti shfrytëzojnë me sukses, me qëllim që procesi i riedukimit dhe riintegrit të fëmijëve të jete me efektiv, duke pasur parasysh rëndësinë e mjekut në ent, mendimet dhe propozimet e tij kanë rëndësi të vecantë nga pjesa tjetër e personelit të burgut.

Mjeku duhet të jetë shumë i kujdesshëm në raport me fëmijët dhe të mos keqpërdorë besim e tyre për arsye se nga përvoja e këtyre praktikave kur mjeku ka keqpërdorur besim e fëmijëve pasojat kanë qënë të rënda dhe negative për realizim e qëllimit të dënimit me burg.

Nga praktika penitensiare theksohet se personat e dënuar i besojnë mjekut dhe psikiatrit dhe rrëfenë disa çështje, probleme dhe preokupime intime të cilat personeli tjetër i institucionit nuk mund ti hetojë dhe ti dijë, këto rrethana, punëtorët shëndetësor duhet ti shfrytëzojnë, me qëllim të aplikimit të mjeteve dhe metodave më të përshtatshme për rehabilitimin dhe riedukimin e personave të dënuar, nga ana tjetër, vecmas insistohet që ky besim reciprok të mos keqpërdoret, sepse, në raste të tilla, pasojat janë të rënda dhe negative për realizimin e procesit të riedukimit dhe rindtegrimit⁶⁹.

3.5 Arsimi i fëmijëve të dënuar

Fëmijët të cilët janë të distancuar nga procesi arsimor kanë më shumë mundësi të kryejnë vepra që me ligj janë të dënuara dhe të përcaktuara si vepra penale, në krahasim me fëmijët të cilët ndjekin në mënyrë të rregullt procesin arsimor. Në burg për fëmijë përpos metodave që përmenden për procesin e riedukimit dhe riintegrit aplikohet edhe arsimimi si mjet i cili do të përfshihet në mjetet me të cilat kryhet tretmani në burg për riedukim dhe riintegrim të fëmijëve pasi pa arsimin nuk mund të paramendohet një tretman i suksesshëm, me dominimin e idesë për arsimin, arsimimi bëhet një ndër metodat të domosdoshme të cilat shfrytëzohen në procesin e riedukimit dhe konsiderohet si metodë e rëndësishme që do të mundësojë aritjen e qëllimit.

Qëllimi i arsimimit të fëmijëve të dënuar është që ato të mos ngelin prapa nga moshatarët e tyre në këtë proces, sipas ligjit për fëmijë në vendin tonë të gjithë fëmijët kanë të drejtë të

⁶⁹ S.Nikolic: Uloga zdrastvenih radnika u procesu resocijalizacije lica lisenih slobode, Penologija, nr.1, 1975, fq.56-57

ndjekin procesin arsimor edhe në qoftë se janë të dënuar, duke pasur parasysh se në këtë mënyrë do të arihet përgatija e fëmijëve edhe për jetën në vazhdimsi.

Për rëndësinë e arsimit të fëmijëve të dënuar janë parqitur mendime të ndryshme ku është vërtetuar rëndësia e arsimit poashtu edhe organizata, shoqata dhe asociacione ndërkombëtarë kanë konsideruar si njëri ndër faktorët më të rëndësishëm për riedukim të fëmijëve të dënuar është arsimimi i tyre.

Në këtë drejtim janë të njohura edhe mendimet dhe pikëpamjet Enriko Ferit, përfaqësuesit eminent të shkollës oiztiviste italiane, ai ishte kundër torturave ndaj të dënuarve dhe insistonte që në procesin e tretmanit të aplikohet si metodë arsimimi dhe shkollimi i personave të dënuar, sidomos emancipimi i tyre kulturor edhe shumë mendimtarë tjerë kishin bindje se shkaki i krimi qëndron në mosdije, primitivizëm dhe nivel të ulët të përgaditjes arsimore dhe profesionale, shkrimtari i madh francez, Viktor Ygo duke dashur të theksojë rëndësinë e arsimit dhe shkollimit në pengimin e kriminalitetit ka thënë: “Hapja e një shkolle, do të thotë mbyllja e një burgu”⁷⁰.

Në entin edukues korrektues në Ohër orët mësimore mbahen nga punonjësit e tjere në këtë institucion pasi mungon një mësues adekuat për fëmijët e dënuar, në kapitullin e fundit do të dëshmojnë vetë fëmijët nga intervistat se kush i'u mban atyre orë mësimore.

⁷⁰D.Atanackovic, vep.e cit. fq. 225-227



Klasa mësimore –Institucionit për fëmijët e entit edukues korrektues Ohër⁷¹

Në institucione korrektuese të cilat e kanë përqafuar sistemin modern dhe bashkëkohor, mbretëron mendimi se arsimimi dhe shkollimi i personave të dënuar duhet të përgaditet dhe të organizohet me përgjegjësi dhe kujdes të madh, personave të dënuar sipas këtij sistemi, duhet tu mundësohet shkollimi dhe arsimimi në të gjitha nivelet, e sidomos atyre personave të cilët tregojnë talent dhe interesim të vecantë në këtë drejtim. Për arritjen e nivelit dhe shkallës së arsimimit e shkollimit si dhe aftësive profesionale personave të dënuar duhet tu lëshohen dëftesa, diploma dhe certifikata të cilat vlejnë edhe në liri, Kjo rrethanë ka rëndësi të madhe për shkak të mundësisë që personat e dënuar, të kycen pa probleme në të gjitha rrjedhat e shkollimit, arsimimit dhe përgatitjes profesionale. Nëpër ente ndëshkimore-përmirësuese, varësisht prej shteteve, ksuhteve dhe rrethanave materiale kadrovike, organizohen shkolla të ndryshme me karaktertë përgjithshëm ose special, në këtë drejtim, mund të organizohen shkolla ekonomike, bujqësore, teknike, shkollat e mjeshtërive dhe zanateve të ndryshme etj, mësimi në këto shkolla vecmas përcillet me mësimin praktik, cka ka rëndësi të vecantë për përgaditje më të gjithanëshme të personave të dënuar⁷².

⁷¹ <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>

⁷² Halili R. 2014, Penologjia, Prishtinë, fq. 195

Të gjitha rethanat që janë pjese e arsimimit si proces në tretmanin e fëmijëve të dënuar kuptohet se janë favorizuese për fëmijët me qëllim që këto tipare që fëmijët do ti fitojnë gjatë periudhës në të cilën janë të privuar nga liri të mund ti shfrytëzojnë në pjesën tjetër të jetës, përpos që të dënuarit do të jenë më të gatshëm për jetën në vazhdim, ata do të shperblehen në forma të ndryshme në rastet kur do të kenë rezultate të mira në procesin e arsimimit, procesi i arsimimit ka për qëllim aritjen e rezultateve pozitive në riedukimin dhe riintegrimin e plotë të tyre.

3.6 Aktivitetet zbavitëse dhe sportive

Aktivitetet zbavitëse dhe sportive janë të pranishme në të gjitha entet korektuese duke marrë parasysh tretmanet tjera që bëhen për riedukim dhe riintegrim të fëmijëve aktivitetet zbavitëse dhe sportive janë të rëndësishë së njëjt për këtë proces, secili ent organizon aktivitete sportive qëllimi i të cilave është që fëmijët përvec metodave tjera të kenë kohë të angazhohen edhe në aktivitete sportive, në ente organizohen gara të ndryshme sportive, poashtu edhe aktivitete kulturore-zbavitëse organizohen në entet korektuese të cilat kanë qëllimin e njëjtë drejt realizimit pozitiv të procesit të riintegrit dhe riedukimit.

Entet duhet të disponojnë salla të leximit bilbloteka poashtu entet duhet të nxjerin revista të ndryshme ku do të vlerësohen të ariturat e të dënuarve, rezultatet e tyre të shfaqen në ato revista, punime të ndryshme të cilat do të kenë autorë fëmijët e dënuar, revistë e cila do të ketë përmbajtjen nga jeta e fëmijëve të dënuar dhe reth procesit që ata po e kalojnë në ent, qëllimi i të gjitha aktiviteteve qofshin zbavitëse apo sportive është që të ngjallin interes nga shumica e të dënuarve që të fillojnë të angazhohen se bashku pasi me fillimin e aktiviteteve të reja ata do të largohen apo këto aktivitete do të ndikojnë që tëk fëmijët të krijohen shprehi të reja dhe të largohen nga shprehitë negative.

Zakonisht aktivitetet sportive kryhen gjatë kohës së lirë të fëmijëve të dënuar, qëllimi i kësaj është që në kohën e lirë fëmijët të mos kenë aq shumë hapsir që të mendojnë për veprime negative mirëpo nëpërmjet këtyre aktiviteteve ata të shpenzojnë kohën e lirë që të mund sa më shpjetë të largohen nga shprehitë e këqija.



Hapësira e dedikuar për sallë ushtrimesh fizike – Institucioni për fëmijët e entit edukues korrektues – Ohër⁷³

Nëpër institucionet korrektuese organzohen gara të ndryshme në sporte të ndryshme me qëllim që të dënuarit të adaptohen në funksionim kolektiv, në frymë kolektive, të veprojnë të bashkuar, të kontrollojnë agresionin dhe nervozizmin, pasi në gara paraqiten agresione të ndryshme që në ent do dilnin në pah gjatë këtyre garave dhe personave tjerë në ent do tu vinin në shërbim këto veti apo momente kur te fëmijët do të paraqiteshin shenja të agresionit që në mënyrë sa më të mirë të mundshme ti evitojnë dhe të instalojnë frymë tjetër mënyre tjetër të funksionimit me qëllim riedukimit dhe risocializimit apo riintegrit të tyre.

3.7 Të drejtat dhe obligimet e fëmijëve sipas rendit shtëpiak në objektin e burgut për fëmijë

Secili ent korrektues ka rendin e tij shtëpiak ku parashihen të gjitha të drejta dhe obligime të cialt i kanë fëmijët e dënuar, rendi shtëpiak ju jepet fëmijëve menjëherë pasi ata të paraqiten në institucion korrektues, të drejtat dhe obligimet e fëmijëve janë të parapara sipas ligjit në

⁷³ <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>

RMV. Personat e dënuar kanë në dispozicion ligjet, aktet nënligjore të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e mbajtjes së dënimit me burgim, të drejtat dhe obligimet e persoave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burg, rendin shtëpiak të institucionit doracakun për personat e dënuar⁷⁴. Në institucion nxirret akt i përgjithshëm me të cilin rregullohet rendi shtëpiak dhe në mënyrë më të përafërt përcaktohet organizimi i punës dhe përcaktohen mënyra e jetesës së personave të dënuar në institucion, aktin e përgjithshëm e nxjerr drejtori i institucionit në pajtim me drejtoin e drejtorisë⁷⁵. Në muajn janar të vitit 2012, drejtoria për zbatimin e sanksioneve noxhri rendin shtëpiak për personat të cilat vuajnë dënimin me burgim në institucionin ndëshkues-korrektues, i cili është i unifikuar dhe vlenë për të gjithë institucionet ndëshkuese- korrektuese. Me këtë rend shtëpiak në mënyrë të përafërt përcaktohet organizimi i punës dhe përcaktohet mënyra e jetesës së personave të dënuar në institucion⁷⁶.

⁷⁴ Решение за распоредување на осудените, казнетите и малолетни лица во казено-поправните и воспитно-поправните установи („Службен весник на Република Македонија“ бр.84/2008)

⁷⁵ Ligji për zbatimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e RMV-së ne. 2/2006,57/10,170/13,43/14, 166/14, 166/14, 33/15, 98/15, 11/16,dhe 08/18 neni 53, paragrafi 1 dhe 2

⁷⁶ Куќен ред за осудени лица кои издржуваат казна затвор во казено-поправна установа, јануари 2012 година, Министерство за правда

Kapitulli IV

4. ANALIZË EMPIRIKE LIDHUR ME EKZEKUTIMIN E DËNIMIT ME BURGIM NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

4.1 Numri i fëmijëve të gjykuar gjatë periudhës kohore: 2013-2018

Numri i fëmijëve të gjykuar gjatë kësaj periudhe kohore për të cilin kishim parapar të paraqes të dhëna dhe analiza nuk është e mundur për shkak se enti statistikor i Republikës së Maqedonisë të Veriut në muajin Nëntor të vitit 2019 nuk ka asnjë të dhënë për vitin 2018, të dhënat të cilat paraqiten në entin statistikor për fëmijët e gjykuar të fundit janë të vitit 2017, andaj sipas këtyre të dhënave do të paraqesim informacione të cilat kanë të bëjnë me numrin e fëmijëve të gjykuar gjatë periudhës 2013-2017 në Republikën e Maqedonisë së veriut.

Tabela 1 – Numri i fëmijëve të lajmëruar					
Viti	2013	2014	2015	2016	2017
Nr i fëmijëve	1005	972	772	587	578

(Enti Statistikor i RMV-së -“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 106)

Në tabelën 1 është paraqitur numri i fëmijëve të lajmëruar si kryerës të veprave penale ku në vitin 2013 kemi 1005 fëmijë të lajmëruar si kryerës të veprave të dënuara me ligj, në vitin 2014 kemi 972 fëmijë, në vitin 2015 kemi 772 fëmijë, në vitin 2016 kemi 587 fëmijë dhe në vitin 2017 kemi 578, sic shihet nga tabela 1 numri i fëmijëve të lajmëruar si kryerës të veprave penale është zvogëluar gati në 50% nga viti 2013 ku numri ishte 1005 ndërsa në vitin 2017 numri është zvogëluar në 578.

Tabela 2 – Procesi gjyqësor		
Propozim për dënim	Procedura nuk është filluar	Procedura përgaditore është pezulluar
370	113	95

(Enti Statistikor i RMV-së-“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 106)

Në tabelën 2 është paraqitur gjendja procedura gjyqësore nga 578 fëmijë të paraqitur ku nga 578 për 370 fëmijë është paraqitur propozim për dënim, për 113 procedura nuk është filluar fare, ndërsa procedura përgaditore është pezulluar për 95 fëmijë.

Tabela 3 – Kohëzgjatja e procesit prej paraqitjes së procedurës deri te marja e vendimit							
Gjithsej	578	deri 1 muaj	prej 1-2 muaj	prej 2-4 muaj	prej 4-6 muaj	prej 6 muaj deri 1 vjet	mbi 1 vjet
		72	84	120	65	204	33
Propozim për dënim	370	-	50	94	46	153	27
Procedura nuk është filluar	113	72	25	10	3	3	-
Procedura është pezulluar	95	-	9	16	16	48	6

(Enti Statistikor i RMV-së -“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 109)

Në tabelën 3 është paraqitur kohëzgjatja e procesit prej paraqitjes së procedurës deri te marja e vendimit, në nivele mujore deri në 1 vit, duke filluar nga 578 të paraqitur, deri në 1 muaj kemi marje të vendimit në 72 raste, prej 1 deri 2 muaj kemi 84 raste, prej 4 deri 6 muaj kemi 120

raste, prej 6 muaj deri 1 vjet kemi 204 raste, dhe mbi një vjet kemi 33 raste, prej të gjithë këtyre rasteve propozim për dënim kemi në 370 raste, procedura nuk është filluar në 113 raste, dhe procedura është pezulluar në 95 raste, propozim për dënim deri në 1 muaj nuk kemi asnjë rast, prej 1 deri 2 muaj kemi 50 raste që është marrur vendim, prej 2 deri 4 muaj 94 raste, prej 4 deri 6 muaj 46 raste, prej 6 muaj deri në 1 vjet kemi 204 raste që ka zgjatur procedura dhe mbi një vjet 33 raste. Porcedura nuk ka filluar gjithsej në 113 raste prej të cilave deri në 1 muaj kemi 72 raste, prej 1 deri 2 muaj 25 raste, prej 2 deri 4 muaj 10 raste, prej 4 deri 6 muaj 3 raste, prej 6 muaj deri në 1 vjet 3 raste dhe mbi një vjet nuk kemi asnjë rast. Procedura është pezulluar në total në 95 raste, deri në një muaj nuk kemi asnjë rast, prej 1 deri 2 muaj kemi 9 raste, prej 2 deri 4 muaj kemi 16 raste, prej 4 deri në 6 muaj njëjtë 16 raste, prej 6 muaj deri në 1 vjet kemi 48 raste, dhe mbi një vjet kemi 6 raste.

Tabela 4 Raporti i fëmijëve që kanë kryer vepër penale në bazë të kombësisë dhe gjinisë të tyre							
Kombësia	Maqedonas	Shqipëtar	Turq	Rom	Boshnjak	Të tjerë	Të panjohur
Meshkuj	170	194	9	158	101	1	10
Femra	7	7	1	11	-	-	-
Gjithsej	177	201	10	169	101	1	10

(Enti Statistikor i RMV-së, -“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 111)

Në tabelën 4 kemi paraqitur raportin e numrit të fëmijëve të gjykuar në bazë të kombësisë dhe gjinisë të tyre, fëmijët të cilët janë gjykuar janë të kombësive të ndryshme si: Maqedonas, Shqipëtarë, Turq, Rom, Boshnjak, Të tjerë dhe të panjohur. Maqedonas kemi 177 të gjykuar prej të cilëve 170 janë meshkuj dhe 7 femra, Shqipëtar kemi 195 meshkuj të gjykuar dhe 7 femra që në total janë 201 që janë më së shumti nga të gjitha etnitetet të gjykuar në vendin tonë, Turq kemi 9 meshkuj dhe 1 femër të gjykuar gjithsej 10, Rom gjithësej kemi 169 fëmijë të gjykuar prej të cilëve 158 janë meshkuj dhe 11 femra, Boshnjak kei 101 të gjykuar dhe të gjithë janë meshkuj, të tjerë kemi 1 dhe të panjohur nga kombësia kemi 10.

Tabela 5: Llojet e veprave penale	
Kunër jetës dhe trupit	55
Kunër të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit	8
Kundër financave publike dhe ekonomisë	2
Kunër pasurisë	374
Sigurisë në komunikacionin publik	38
Komunikacionit të rregullt	1
Rendit Publik	71
Të tjera	29
Gjithsej	578

(Enti Statistikor i RMV-së, -“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 112)

Në tabelën 5 kemi paraqitur llojet e veprave penale për të cilat janë gjykuar fëmijët ku duhet theksuar se pjesa më e madhe e veprave penale është kundër pasurisë, numri në bazë të veprave penalë është paraqitur në këtë mënyrë, vepra penale kundër jetës dhe trupit kemi 55, kundër të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit kemi 8, kundër financave publike dhe ekonomisë kemi 2 vepra penale, kundër pasurisë kemi 374 vepra penale që janë veprat të cilat përsëriten më së shpeshti, kundër komunikacionit publik kemi 38 vepra penale, kundër komunikacionit të rregullt 1, kundër rendit publik 71 dhe të tjera 29.

4.2 Numri i fëmijëve të dënuar me burgim gjatë periudhës kohore: 2013-2018

Me të njejtën problematikë ballafaqohem edhe në këtë pikë të punimit ku nga enti statistikor i Republikës së Maqedonisë të Veriut nuk paraqiten të dhëna për vitin 2018, pra në muajn Nëntor të vitit 2019 nuk kemi asnjë të dhënë nga enti statistikor për fëmijët e fënuar me burg gjatë periudh 2018, për këtë arsye detyrohem që të paraqes të dhëna nga numri i fëmijëve të dënuar me burgim deri në vitin 2017.

Tabela 6: Numri i fëmijëve të dënuar sipas viteve 2013-2017					
Vitet	2013	2014	2015	2016	2017
Nr. i fëmijëve të dënuar	473	461	348	468	368

(Enti Statistikor i RMV-së, -"Kryerës të veprave penale 2017", fq. 115)

Në tabelen 6 është paraqitur numri i fëmijëve të dënuar me burg sipas viteve nga viti 2013 deri në vitin 2017 për arsye se deri në këtë vit janë të paraqitura të dhënat në entin statistikor, në vitin 2013 kemi 473 fëmijë të dënuar, në vitin 2014 kemi 461 fëmijë të dënuar, në vitin 2015 kemi 348 fëmijë të dënuar, në vitin 2016 kemi 468 fëmijë të dënuar dhe në vitin 2017 kemi 368 fëmijë të dënuar me burg.

Tabela 7: Llojet e veprave penale dhe numri i tyre gjatë viteve 2013-2017					
Llojet e veprave	Vitet				
	2013	2014	2015	2016	2017
Kundër jetës dhe trupit	39	47	43	70	29
Kundër lirisë dhe të drejtave të qytetarit	5	-	2	7	2
Kundër nderit dhe reputacionit	-	-	1	-	-
Kundër lirisë dhe moralit seksual	5	14	13	7	2
Kundër shëndetit të njeriut	12	4	7	13	7
Kundër martesës, familjes dhe rinisë	1	1	-	2	-
Kundër financave publike dhe ekonomisë	3	3	5	4	1
Kundër pasurisë	353	267	198	257	251
Kundër sigurisë të përgjithshme të njeriut dhe pasurisë	4	6	2	2	2
Kundër sigurisë në komunikacion publik	24	14	28	22	32
Kundër komunikacionit të rregulluar	-	-	1	1	2
Kundër rendit publik	25	100	42	79	37

Të tjera	2	5	6	4	3
Gjithësej	473	461	348	468	368

(Enti Statistikor i RMV-së, -“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 115)

Në tabelën 7 janë paraqitur llojet e veprave penale për të cilat janë dënuar fëmijët nga viti 2013 deri në vitin 2017, duke filluar nga veprat kundër jetës dhe trupit që në vitin 2013 kemi 39 vepra të tilla, në vitin 2014 47 vepra, në vitin 2015 kemi 43 vepra, në vitin 2016 kemi 70 vepra dhe në vitin 2017 kemi 29 vepra kundër jetës dhe trupit, vepra kundër lirisë dhe të drejtave të qytetarit në vitin 2013 kemi 5 të dënuar për këtë vepër, në vitin 2014 asnjë, në vitin 2015 kemi 2 të dënuar për këtë vepër, në vitin 2016 kemi 7 kryerës të kësaj vepre, në vitin 2017 kemi 2 kryerës të kësaj vepre, vepra kundër nderit dhe reputacionit kemi vetëm 1 kryerës në vitin 2015, kundër lirisë dhe moralit seksual në vitin 2013 kemi 5 kryerës të kësaj vepre, në vitin 2014 kemi 14 kryerës, në vitin 2015 kemi 13 kryerës, në vitin 2016 kemi 7 kryerës të kësaj vepre dhe në vitin 2017 kemi 2 kryerës të kësaj vepre, Kundër shëndetit të njeriut në vitin 2013 kemi 12 të dënuar si kryerës të kësaj vepre, në vitin 2014 kemi 4 të dënuar për këtë vepër, në vitin 2015 kemi 7 të dënuar si kryerës të kësaj vepre, në vitin 2016 kemi 13 të dënuar si kryerës të kësaj vepre dhe në vitin 2017 kemi 7 të dënuar. Vepra kundër martesës, familjes dhe rinisë në vitin 2013 kemi 1 të dënuar për këtë lloj të veprës penale, në vitin 2014 poashtu 1 të dënuar, në vitin 2015 nuk kemi në vitin 2016 kemi 2 të dënuar për këtë lloj të veprës penale dhe në vitin 2017 nuk kemi asnjë të dënuar për këtë lloj të veprës penale. Vepra penale kundër pasurisë janë veprat që përsëriten më së shpeshti që nga viti 2013 deri në 2017 ata qëndrojnë më shumë për nga numri i fëmijëve të dënuar për këtë vepër duke filluar nga viti 2013 ku kemi 353 të dënuar për këtë vepër në vitin 2014 kemi 267 të dënuar për këtë vepër, në vitin 2015 kemi 198 të dënuar për këtë vepër, në vitin 2016 kemi 257 kryerës të kësaj vepre dhe në vitin 2017 kemi 251 fëmijë të cilët janë dënuar për kryerje të veprës penale kundër pasurisë. Vepra penale kundër sigurisë të përgjithshme të njeriut dhe pasurisë gjatë vitit 2013 kemi 4 raste të sanksionimit për këtë lloj të veprës penale, në vitin 2014 kemi 6 raste të sanksionimit për këtë lloj të veprës penale, në vitin 2016 kemi 2 raste të sanksionimit të fëmijëve si kryerës të kësaj vepre penale, në vitin 2016 poashtu kemi 2 të dënuar për këtë vepër, njëjtë edhe në vitin 2017

kemi 2 të dënuar si kryerës I kësaj vepre penale. Vepra penale kundër sigurisë në komunikacion public në vitin 2013 kemi 24 raste, në vitin 2014 kemi 14 raste, në vitin 2015 kemi 28 raste, në vitin 2016 kemi 22 raste dhe në vitin 2017 32 raste. Vepra kundër komunikacionit të rregulluar në vitin 2013 dhe 2014 nuk kemi të dënuar për këtë vepër, ndërsa në vitin 2015 dhe 2016 kemi nga 1 të dënuar për këtë vepër, dhe në vitin 2017 kemi 2 fëmijë të dënuar për këtë vepër. Vepra kundër rendit publik në vitin 2013 kemi 25 vepra të tilla të kryera, në vitin 2015 kemi 100 vepra të tilla, në vitin 2015 kemi 42 vepra të kryera kundër rendit publik në vitin 2016 kemi 79 vepra të këtij lloji dhe në vitin 2017 kemi 37 vepra kundër rendit publik të kryera nga fëmijët. Vepra të tjera të gjatë vitit 2013 kemi 2, gjatë vitit 2014 kemi 5, gjatë vitit 2015 kemi 6, gjatë vitit 2016 kemi 4 dhe gjatë vitit 2017 kemi 3 vepra.

Tabela 8: Dënimi me burg i fëmijëve prej moshës 16-18 vjet					
Deri në 10 vjet	Prej 8-10 vjet	Prej 5-8 vjet	Prej 3-5 vjet	Prej 2-3 vjet	Deri 2 vjet
	-	1	3	-	1
Gjithsej	5				

(Enti Statistikor i RMV-së, -“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 117)

Në tabelën 8 është paraqitur numri i fëmijëve të dënuar me burg dhe periudha kohore për të cilën janë dënuar, ku shihet se deri në 10 vjet apo me dënim maksimal nuk kemi asnjë të dënuar, poashtu prej 8 deri në 10 vjet nuk kemi asnjë rast, ndërsa prej 5 deri 8 vjet kemi 1 fëmijë të dënuar, prej 3 deri në 5 vjet kemi 3 fëmijë të dënuar, prej 2 deri në 3 vjet nuk kemi asnjë fëmijë të dënuar dhe deri në 2 vjet kemi një fëmijë të moshës 16 deri 18 vjet të dënuar.

Tabela 9: Masat edukuese të shqiptuara për fëmijët të moshës 16-18 vjet		
Masat diciplonore	Qortim	Qendër diciplonore
	39	-
Masat e mbikëqyrjes së shtuar	Prindërore	Kujdestari institucionale
	128	75
Masë institucionale	Institucion edukues-arsimor	Shtëpi edukuese-korrektuese
	3	6
Gjithsej	251	

(Enti Statistikor i RMV-së-“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 120)

Në tabelën 9 është paraqitur llojet e masave edukuese të cilat janë shqiptuar fëmijëve të moshës 16 deri 18 vjecare, masë diciplonore qortim kemi 39 raste ku u është shqiptuar fëmijëve, masë të mbikëqyrjes së shtuar prindërore kemi 128 raste, ndërsa masat e mbikëqyrjes së shtuar nga kujdestaria institucionale kemi 75 raste, masë institucionale si dërgim në institucion edukues-arsimor kemi 3 raste dhe dërgimi në shtëpi edukuese korrektuese kemi 6 raste ku është shqiptuar kjo masë ndaj fëmijëve të moshës prej 16 deri 18 vjet.

Tabela 10: Raporti i fëmijëve që kanë kryer vepër penale në bazë të kombësisë së tyre								
Kombësia	Maqedone	Shqiptar	Turq	Romë	Sërb	Boshnjak	Të tjerë	Të panjohur
	87	125	7	65	1	5	2	76
Gjithsej	368							

(Enti Statistikor i RMV-së, -“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 125)

Në tabelën 10 është paraqitur kombësia e fëmijëve të cilët kanë janë të dënuar, në bazë të kombësis maqedonase kemi 87 fëmijë të dënuar, në bazë të kombësisë shqipëtare kemi më shumë fëmijë të dënuar se të gjitha kombësitë tjera ku janë të regjistruara 125, fëmijë të dënuar të kombësisë turke kemi 7, fëmijë të dënuar të kombësisë romë kemi 65, fëmijë të dënuar të kombësisë serbe kemi 1, fëmijë të dënuar boshnjak kemi 5, të tjerë kemi 2 dhe të panjohur kemi 76 fëmijë të dënuar.

Tabela 11: Niveli arsimor I fëmijëve të dënuar						
Klasa 1-4	Klasa 5-8	Viti 1-2	Viti 3-4	Të lartë	Të panjohur	Nuk ndjek process arsimor
2 fëmijë	4 fëmijë	56 fëmijë	56 fëmijë	1 fëmijë	118 fëmijë	131 fëmijë
Gjithsej	368					

(Enti Statistikor i RMV-së-“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 127)

Në tabelën 11 është paraqitur niveli arsimor I fëmijëve të dënuar ku në bazë të të dhënave nga enti statistikor i RMV-së kemi këtë të dhëna: fëmijë të dënuar të cilët kanë aritur nivel arsimor nga klasa e parë në të katërtën janë 2, fëmijë të dënuar të cilët kanë aritur nivelin arsimor nga klasa e 5 deri në të 8 kemi 4 fëmijë të dënuar, shkollim të mesëm prej vitit të parë deri në të dytin kemi 56 fëmijë të dënuar, ndërsa prej vitit të 3 deri të 4 poashtu kemi 56 fëmijë të dënuar, me nivel arsimor të lartë kemi 1 fëmijë të dënuar, të panjohur për nga niveli arsimor kemi 118 fëmijë, dhe 131 fëmijë kemi të cilët asnjëherë nuk kanë ndjekur process mësimor.

Tabela 12: Statusi familjar I fëmijëve të dënuar				
Jetojnë me prindërit	Jeton me babain nëna nuk jeton	Jeton me nënën babai nuk jeton	Jeton me babin – prindër të ndarë	Jeton me nënën – prindër të ndarë
300	1	6	9	21
Gjithsej	337			

(Enti Statistikor i RMV-së, -“Kryerës të veprave penale 2017”, fq. 128)

Në tabelën 12 është paraqitur statusi familjar i fëmijëve të dënuar ku 300 fëmijë të dënuar jetojnë me prindërit, 1 rast kemi ku nëna nuk jeton dhe fëmiju jeton me babain, 6 raste të fëmijë të dënuar kemi që babai i tyre nuk jeton dhe ata jetojnë me nënën, 9 raste kemi kur fëmiju jeton me babin për shkak se prindërit janë ndarë, dhe 21 raste të dënimit të fëmijëve kemi që jetojnë me nënën për shkak të ndarjes prindërore.

4.3 Anketa e realizuar me fëmijë të dënuar me burgim

Anketa që ishte planifikuar të realizohet për këtë punim nuk është mundësuar për arsye se kërkesa e dërguar deri në Ministrinë e drejtësisë për të vizituar burgun e Ohrit në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është kthyr asnjë përgjigje ndaj kësaj kërkesë, gjë që pamundëson realizimin e anketës të planifikuar. Duke pasur parasysh kohën të cilën e kemi në dispozicion për këtë punim nuk korespondon me kohën të cilën do të nevojitej për të ridërguar një kërkesë tjetër.

Duke pasur në konsideratë këto rrethana si zgjidhje më e mirë vendosëm se është të shfrytëzojmë të dhëna nga anketa e realizuar e Prof. Blerta Ahmed Arifi në muajin Maj të vitit 2017, poashtu kjo anketë vazhdon të këtë po të njëjtën rëndësi sikur të ishte realizuar sot pasi nga të dhënat e entit statistikor kuptojmë se numri i të dënuarve vazhdon të jetë i njëjtë, andaj në vazhdim do të përcjellim anketën e njëjtë.

Anketa është realizuar në mënyrë të qasjes së drejtëpërdrejtë nga ana e fëmijëve, me çrast ata u janë përgjigjur pyetjeve aty për aty, në disa raste duke u ofruar asistencë nga organizuesi i anketës dhe personeli i institucionit, sepse disa nga fëmijët kishin vështirësi në shkrim dhe lexim. Ky fakt e vështirësoi pak tempon e realizimit të këtij procesi, si edhe duke pasur parasysh faktin se kjo ishte anketë anonime ku fëmijët duhej të përgjigjeshin individualisht dhe duke u mbrojtur në mënyrë absolute privatësia e tyre gjatë dhënies së përgjigjeve: Me këtë rast ngelet një dozë dyshimi për faktin se sa fëmijët ishin të sinqertë në rastin kur duhej gojarisht të

jepnin përgjigje në pyetjet të cilat i'u parashtroheshin në prani të personelit të sigurimit të burgut⁷⁷.

Anketa u realizua në hapsira të burgut Brenda disa orësh u arrit që të gjithë fëmijët të mund ti plotësonin pyetësorët në atmosferë shumë bashkëpunuese nga ana e tyre si dhe e vetë personelit, të cilët i inkurajuan fëmijët për të qenë sa më objektiv gjatë dhënies së përgjigjeve⁷⁸.

Pyetësi përbëhet nga dy pjesë, shumica e pyetjeve me opcion të përgjigjeve të shkurtëra, si shënim, rrethime, ndërsa vetëm dy pyetjet e fundit me kërkesën që fëmijët të mund të shënonin më tepër informacione të kërkuara⁷⁹.

Pjesa e parë e anketës përmbanë pyetje të përgjithshme, si Gjinia; Mosha; Përkatësia etnike; Vendbanimi; Lloji i sanksionit penal që e vuajnë; Kogëzgjatja e masës/dënimit; Niveli i shkollimit; Lloji i veprës penale për të cilën është gjykuar fëmiu⁸⁰.

Pjesa e dytë përmbanë këto pyetje sin ë vijim:

- A keni qenë të dënuar më parë me dënim me burgim?
- A keni qenë të gjykuar/dënuar më herët? Nëse po, me cfarë sanksioni?
- Sa ka pasur ndikim pozitiv tek ju masa e vuajtur deri tani?
- C'ka më së shumti ju ka ndihmuar gjatë tretmanit nënt?
- Me cilat kushte të entit/trajtimit nuk jeni të kënaqur?
- A ndqini orë mësimore, dhe nëse po nga kush (kush ua mban ato orë)?
- Cka ju mungon për tretman më të mirë?⁸¹

Qëllimi i parashtrimit të pyetjeve nga pjesa e parë ishte që të pasqyrohet struktura e fëmijëve të anketuar, sa i përket kategorizimit të tyre sipas moshës, përkatësisë etnike, nivelit të shkollimit etj. Kurse pjesa e dytë e anketës përmban pjesën kryesore, nga e cila pritej të nxirren rezultatet kryesore, rreth fakteve që kanë të bëjnë me tretmanin e fëmijëve të gjykuar Brenda

⁷⁷ Ahmedi Arifi B. 2018, Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M. gjatë periudhës kohore 2006-2015, Tetovë, fq. 156

⁷⁸ Poaty, fq. 156

⁷⁹ Po aty, fq. 156

⁸⁰ Po aty, fq. 156

⁸¹ Ahmedi Arifi B. 2018, Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M. gjatë periudhës kohore 2006-2015, Tetovë, fq. 156

institucionit penitensiar dhe nxjerrjen e përgjigjes në pyetjen kyce rreth suksesit të realizimit të qëllimit të preventivës special apo të ashtuquajturës “preventive terciere” e dënimit me burg/masës së entit ndaj fëmijëve të gjykuar, respektivisht të dënuar⁸².

Pyetësorin e plotësuan të gjithë fëmijët në hapsirën e entit ndëshkues-korrigjues në Ohër. Gjithsej ishin 23 fëmijë, nga të cilët 5 ndaj të cilëve po ekzekutohej dënim me burg për fëmijë, dhe 18 të cilët e vuanin masën edkuese – Dërgim në shtëpinë edukuese-përmirësuese⁸³.

Sa ipërket gjinisë të gjithë ishin të gjinisë mashkullore. Ekzekutimi i dënimit me burg të fëmijëve tëënuara femra në Republikën e Maqedonisë së Veriut realizohet në institucionin penitensiar në Idrizovë, ku fatkeqësisht femrat e mitura të dënuara qëndrojnë dhe vuajnë dënimin së bashku me femrat madhore të dënuara me burg. Megjithatë fakt inkurajues është situatë reale se gjatë vitit 2017 në vendin tonë nuk kishte asnjë fëmijë të gjinisë femërore të dënuar me dënim me burgim⁸⁴.

Pjesa I e anketës:

Tabela 13 – Numri, Gjinia, Mosha e fëmijëve të dënuar me burg për fëmijë			
Gjithsej	5		
Gjinia	Mashkuj: 5	Femra: 0	
Mosha	18 vjet	19 vjet	22 vjet
	2	2	1

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 166)

Sic është paraqitur në tabelën 13 – pra në vitin 2017 ishin 5 fëmijë të dënuar me dënim me privim nga liria, i cili ekzekutohet në institucionin ndëshkues-përmirësues për fëmijë në Ohër. Të gjithë janë të gjinisë mashkullore. Dy janë 18 vjecar, dy janë 19 vjecar, kurse njëjstë 22 vjecar⁸⁵.

⁸² Po aty, fq. 157

⁸³ Po aty, fq. 157

⁸⁴ Po aty, fq. 157

⁸⁵ Ahmedi Arifi B. 2018, Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M. gjatë periudhës 2006-2015, Tetovë, fq. 167

Tabela 14 – Përkatësia etnike dhe vendbanimi I fëmijëve të dënuar me burg			
Përkatësia etnike	Romë	Maqedonas	Shqiptarë
	2	1	2
Vendbanimi	Shkup	Shtip	Kumanovë
	3	1	1

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 167)

Në tabelën 14 është paraqitur numri I fëmijëve të anketuar sipas përkatësisë së tyre etnike dhe sipas vendbanimit të tyre. Dy prej tyre janë romë dhe dy të tjerë shqipëtarë, kurse një maqedonas. Tre nga fëmijët kanë vendbanime në qytetin e Shkup, një në Shtip dhe një në Kumanovë⁸⁶.

Tabela 15 – Shkalla e edukimit të fëmijëve të dënuar me burg						
Niveli i shkollimit	Fillor	Klasa	V-pestë	VII- shtatë	VIII- tetë	
			1	1	1	
	I mesëm	Viti	III- tretë			
			1			
Analfabet			1			

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 167)

Në tabelën 15 është paraqitur numri I fëmijëve sipas shkallës së edukimit të tyre. Tre prej tyre kanë mbaruar vetëm nivelin fillor të edukimit, dhe atë secili në nivele të ndryshme, njëri e ka mbaruar atë, ndërsa dy të tjerët – klasën e V-të; VII-të. Njëri nga fëmijët ka mbaruar vitin e tretë të shkollës së mesme para se të privohej nga liria. Kurse një prej tyre ishte analfabet-aspak nuk kishte shkuar në shkollë⁸⁷.

⁸⁶ Po aty, fq. 167

⁸⁷ Po aty, fq. 167

Tabela 16 – Kohëzgjatja e burgimit dhe lloji i veprës penale për të cilën është dënuar				
Kohëzgjatja e dënimit me burg	Vite	2v	5v	9v
	Nr. i fëmijëve	1	2	2
Lloji i veprës penale për të cilën është dënuar⁸⁸			Nr. i fëmijëve	
Vrasje			1	
Grabitje			3	
Lëndim i rëndë trupor, Grabitje, Shitje të lëndëve narkotike			1	

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 168)

Në tabelën 16 janë paraqitur për secilin fëmijë të anketuar rezultatet lidhur me kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar dhe llojin e veprës penale për të cilën janë dënuar. Është interesant e dhëna se dy nga fëmijët janë dënuar me kohëzgjatje afatgjate (afër maksimumit të paraparë ligjor për këtë dënim) prej 9 vitesh, dy të tjerë me 5 vite dhe një me 2 vite⁸⁹.

Njëri i dënuar me 9 vite burg është i dënuar për veprën penale Vrasje; Tjetri i dënuar me po aq vite (9 vite) është dënuar me këtë dënim të vvetëm për kryerje të më shumë veprave penale, si Grabitje, Shkaktim i lëndimit të rëndë trupor, Shtije të lëndëve narkotike. Tre fëmijë janë dënuar për kryerje të veprës penale Grabitje⁹⁰.

⁸⁸ Të dhënat e paraqitura janë bazuar në deklaratimet e fëmijëve të anketuar. Vërtetësia e tyre është relative, duke pasur parasysh faktin se fëmijët në disa raste mund të mos ishin të sinqertë plotësisht gjatë përgjigjeve. P.sh. tek pyetja për llojin e veprës penale për të cilën është dënuar i mituri, njëri nga të miturit nuk u tregua i sinqertë – duke u deklaruar se ka kryer Grabitje, por në fakt është dënuar për vepër penale sulm seksual ndaj fëmijut në moshë shumë të re! Kjo sepse fëmiju nuk mundej vetë ta plotëson pyetësin dhe gjatë kontaktit direkt verbal me organizuesin e anketës – si duket ka hezituuar për ta treguar të vërtetën!

⁸⁹ Po aty, fq. 168

⁹⁰ Po aty, fq. 168

Pjesa II e anketës së realizuar me fëmijë të dënuar me burgim:

Tabela 17: A keni qenë të gjykuar më parë?	
PO	3
JO	2

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 168)

Në tabelën 17 është paraqitur gjendja e fëmijëve të dënuar me burg për fëmijë, sipas asaj nëse anë të gjykuar për herë të parë ose kanë qenë të gjykuar edhe më parë, respektivisht a janë kryerës primaë apo recidivist. Tre prej tyre kanë qenë të gjykuar dhe më herët, kurse dy prej tyre jo⁹¹.

Tabela 18: Nese keni qentë të gjykuar me herët, cfarë sanksioni është shqiptuar ndaj jush?

JO-2 fëmijë; PO- 3 fëmijë

1 fëmijë – Burg për të mitur

1 fëmijë – Dërgim në shtëpi edukuese – nga 6 muaj, dhe një herë me burgim për 1 vit

1 fëmijë – Dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 169)

Qëllimi I këtyre dy pyetjeve, të paraqitura në tabelen 17 dhe 18 është që të pasqyrohet efektiviteti i sanksioneve penale ndaj fëmijëve. Nëse ndaj fëmijëve të gjykuar do të arrihej efekti i (ri)edukimit të tyre, nuk do paraqiteshin raste të fëmijëve recidivistë. Shumiva e fëmijëve të dënuar me burg (3 nga 5 fëmijët) janë përsëritës, respektivisht të dënuar më herët për vepra të tjera penale⁹².

⁹¹ Po aty, fq. 168

⁹² Po aty, fq. 169

Tabela 19: Sa ka pasur ndikim pozitiv tek ju dënimi I vuajtur deri tani?		
Shumë	Ndopak	Shumë pak/Aspak
4	-	1

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 169)

Sipas tabelës 19 shumica e fëmijëve (4) e konsiderojnë vuajtjen e dënimit me burg – tretmanin penitenciar si faktorë pozitiv në përmirësimin e sjelljeve/bindjeve të tyre. Ndërsa një prej fëmijëve të anketuar është përgjigjur se qëndrimi në burg nuk ka ndikuar aspak pozitivisht tek ai, respektivisht tretmani që ofrohet në këtë institucion nuk I ka ndihmuar atij për përmirësimin e gjendjes/sjelljes së tij. Në vazhdim në Tabelat 20 dhe 21 janë paraqitur përgjigjet e fëmijëve rreth pyetjeve që lidhen me kushtet e tretmanit penitenciar – të dobishme/jot të dobishme për fëmijët⁹³.

Tabela 20: C’ka më së shumti ju ka ndihmuar gjatë tretmanit në burg?

Disa nga përgjigjet më të shpeshta: Biseda me psikologin dhe seancat në grup me fëmijët e tjerë; Kursi për kuzhinier; Puna në kuzhinë; Një fëmijë kishte mbaruar shkollimin e mesëm në SHM “Vanco Pitoshevski” në Ohër; Asgjë, vetëm puna individuale si dëgjimi I muzikës, leximi I librave dhe shkrimi I poezive..

Tabela 21: Me cilat kushte të entit/trajtimin nuk jeni të kënaqur?

Përgjigje më të shpeshta (higjiena, Personeli apo Siguria etj)⁹⁴

Higjiena e dobët (këtë e kishin shënuar të pesë fëmijët e anketuar); Hapsira shumë e ngushtë, Siguria, Mungesa e kushteve elementare për jetesë, e cila I kushtëzon fëmijët që të marrin gjithcka prej shtëpive të tyre.

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 169;170)

⁹³ Po aty, fq. 169

⁹⁴ Ankesat e fëmijëve të dënuar ishin deri diku të njehta me at të fëmijëve të gjykuar me masën e entit, meqenëse shfrytëzonin të njehtin objekt, të njehtën kuzhinë, të njehtat dhoma dhe i njehti tretman nga i njëjti personel minimal (dy psikologe dhe një edukatore). Vetëm hapësira e oborrit ku fëmijët kalojnë aktivitetet Brenda ditës është ndarë në mes me një ndarsëse të rrjetës, e cila ua ndalon kontaktin fizik njëri palë me tjetrën!

Nga të dhenat në tabelën 22 edhe njëherë vërtetohet gjendja reale fëmijëve të gjykuar me sanksione që kanë për pasojë privimin nga liria (masa të entit/burg për fëmijë) në raport me procesin edukativo-arsimor. Kjo e drejtë e fëmijëve dhe njëkohësisht obligim i institucioneve shtetërore përkatëse nuk realizohet në praktik⁹⁵.

Tabela 22: A ndiqni orë mësimore, nëse po nga kush?	
JO	3
PO	2
• Mbajmë orë mësimore me psikologun, edukatoren ose nga rojtarët. • Njërit i është mundësuar që të kryejë jashtë shkollimin e mesëm, ku e ka marrë edhe diplomën, në të cilën normalisht nuk shënohet sështë fituar gjatë vuajtjes së dënimit me burg.	

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 170)

Është shqetësues rezultati nga kjo pyetje, kur shihet se fëmijët përgjigjen se orë mësimore iu mbajnë punonjësit policore të sigurimit të burgut ose nga psikologja⁹⁶

⁹⁵ Poaty, fq. 170

⁹⁶ Po aty, fq. 170

Tabela 23: C'ka ju mungon për tretman më të mirë?

Përgjigjet më të shpeshta të fëmijëve:

Mungesa e mjekut të përgjithshëm, stomatologut (shumica e fëmijëve kishin gjendje të keqe të shëndetit oral); Shkollimi; Aktivitet sportive, pajisje për aktivitete sportive, si: Fusha për futboll, tenis, lojra të ndryshme, kompjutera; ushqim më i pasur etj.

(Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015, fq. 170)

Përgjigjet e fëmijëve të paraqitura në tabelën 23 rreth kushteve që i'u mungojnë ishin thuajse identike me ata të fëmijëve të anketuar të gjykuar me masën edukuese të entit, si mungesa e mjekut të përgjithshëm, stomatologut, shkollimi, aktivitetet sportive, pajisje për aktivitete sportive etj⁹⁷

⁹⁷ Po aty, fq. 170

PËRFUNDIM

Pas një vështrimi të përgjithshëm të ekzekutimit të dënimit me burg për fëmijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mund të vijmë në përfundim se kriminaliteti i fëmijëve është një ndër fenomenet më të rrezikshme që i kanoset shoqërisë në përgjithësi.

Ekzekutimi i dënimit me burg për fëmijë në vendin tone është i rregulluar konform kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare të drejtësisë për fëmijë.

Ligji për ekzekutimin e dënimit për fëmijë garanton barazinë dhe paanshmërinë e zbatimit të sanksioneve, ndalon diskriminimin në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës dhe fesë. Ligji si i tillë është në bazë të të gjithave standardeve evropjane ku parashihen respektimi i të gjitha të drejtave të fëmijëve dhe masa me burgim parashihet si masë e fundit e cila duhet të i'u shqiptohet fëmijëve në procesin e riedukimit dhe riintegrit.

Nga hulumtimi i realizuar u vërtetua hipoteza e paraqitur në propozim tezë se ekzekutimi i dënimit me burg ndaj fëmijëve has në ngecje në drejtimin de facto, kur ndaj fëmiut ndërmerren masa në kuadër të tretmanit penitenciar në entin e caktuar korrektues ndëshkues ku ekzekutohet ky lloj i dënimit. Kushtet të cilat ofrohen nga ana e shtetit në këtë ent nuk ofrojnë mundësi të mjaftueshme që tek fëmijët e dënuar me dënimin me burg të arrihet efekti i këtij dënimi- edukimi, socializmi, si dhe prevencioni special.

Kushtet sanitare, numri i personelit si dhe programet joadekuat për riedukim të fëmijëve të dënuar paraqesin problematikë shumë serioze e cila në praktikë nuk lejon që ekzekutimi i dënimit me burg ndaj të dënuarve të rinjë të arrijë efektin e kërkuar.

Problematika më e madhe që është hasur në këte hulumtim është procesi pas shqiptimit të sanksionit për fëmijë. Kushtet me të cilat përballen fëmijët pasi dërgohen në burg për fëmijë nuk janë në bazë të standardeve ndërkombëtare duke pasur parasysh se burgu për fëmijë në Ohër është në një lokacion të papërshtatshëm i cili është i rethuar me banim dhe i ndarë me rrjetë të hekurt nga pjesa e burgut ku bëhet ekzekutimi i saës edukuese të entit Dërgim i fëmiut në Shtëpi edukuese përmirësuese! Kontakti ishte i mundshëm në mes të dy kategorive të ndryshme të të dënuarve.

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në procesin e riedukimit dhe riintegrit vijmë në përfundim se në vendin tonë ky proces është shumë problem për tu arritur me efikasitet pasi kushtet nuk janë të nivelit të duhur.

Nga të gjitha të dhënët që kemi paraqitu në këtë punim mund të vijmë në përfundim se duhet angazhim më serioz i personave të punësuar në institucionet korrektuese ndëshkuese dhe në vazhdimësi të përmirësohen kushtet metodat dhe mjetet të cilat përdoren për risocializim të fëmijëve. Mund të konstatohet se angazhimi i deritanishëm nuk është serioz dhe se duhet ofruar kushte në këto ente penitensiare që fëmijët do të mund të gëzonin kushte sipas rregullave ndërkombëtare për drejtësinë e fëmijëve.

REKOMANDIME

Si ndryshim i menjëhershëm dhe i pakompromis është që në burgun për fëmijë në Ohër të ketë profesor i cili do të mbajë orët mësimore dhe mjek të specializuar i cili do të qëndrojë në ambientet e burgut sipas dispozitave ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përmirësimi i kushteve në burg për fëmijë, duke filluar prej higjienës, nxemjes, hapsirave për aktivitete zbavitëse, apo ndërtimin e një objekti të ri në një lokacion të përshtatshëm. Aparati shtetëror të investojë në krijimin e qendrave, institucionet të ndryshme të cilat do të kenë përgjegjësi të luftojnë dhe të parandalojnë veprat penale të fëmijëve me anë të politikave dhe strategjive të ndryshme të cilat do të përgaditen nga persona të profesionalizuar dhe të kualifikuar në luftimin e kriminalitetit të fëmijë.

Në sistemin edukativo arsimor të kemi lëndë të posaçme për kriminalitetin e fëmijve ku fëmijët të informohen se cilat veprime janë të ndaluara, pasojat e tyre, dëmi që shkaktojnë etj.

Trajnime dhe ligjerata të ndryshme nga organet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme, krijimin e një sektori të veçantë i cili do të ketë për detyrë kycjen direkte nëpër institucione arsimore ku do të kenë hapsirë për ligjerata dhe trajnime të ndryshme me qëllimi të luftimit të kriminalitetit të fëmijëve.

Duke pasur parasysh se forma më i shpeshtë e veprës penale që kryhet nga fëmijët është ajo kundër pasurisë, na jep shenjë të kuptojmë se kemi problem me ekonominë stabile në shoqërinë tone.

Duke pasur parashyshë këtë karakteristikë të rëndësisë së madhe shteti duhet të reagojë dhe të mundësojë kushte më të mira për jetesë për të gjitha kategoritë e familjeve, ndihma të mjaftueshme për jetë normale për rastet sociale, ndihmesë financiare ndaj fëmijëve të cilët janë raste sociale, asistencë pa pagesë mjekësore dhe politika të ndryshme për të ndikuar në ngritjen e nivelit ekonomik në familjet dhe shoqërinë në vendin tonë.

Të reagohe në mënyrë sa më të shpejtë te fëmijët që paraqesin shenjat e para të kriminalitetit sidomos në institucionet edukativo arsimore, dhe në shoqëri, të reagohe tek fëmijët të cilët paraqiten të përshirë në lypësi, duke u mundësuar atyre kyçjen në trajnime të ndryshme në dobi të tyre dhe duke i'u marrur kohën e lirë të cilën e kanë në dispozicion e cila do të mund të ndikonte negativisht në sjellen e tyre, siç mund të jetë rasti i përfshirjes së tyre në kryerje të veprimeve delikuate e kriminale.

LITERATURA

- Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015
- Salihu, I. (2012) E drejta penale
- Osmani, A. (2013) Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve.
- Ahmedi Arifi, B. (2018) Politika penale ndaj kriminalitetit të feëmojëve dhe metodika e zbulimit të tij në R.M gjatë periudhës kohore 2006-2015
- Halili, R. (2014) Penologjia
- Ahmedi Arifi, B. (2019) Delikuenca e të miturve.
- Hajdari, A. (2010). Sistemi i Drejtësisë për të mitur. Prishtinë.
- Arifi, B. (2017). THE CHILD CRIME PHENOMENON IN REPUBLIC OF MACEDONIA: 2006-2015. ANNUAL of ISPJR , XLI (I), 103-104.
- Božičević-Grbić M. & Roksandić Vidlička S. (2011). Reforma maloljetničkog prava i sudovanja, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu. [Croatian Annual for Criminal Law and Practice], Vol. 18, No. 2, , 715.
- Hajdari, A. (2010). Sistemi i Drejtësisë për të mitur. Prishtinë.
- INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur. Shkup: Këshilli shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve, (2013).
- Kambovski, V. (2007). E DREJTA PENALE Pjesa e përgjithshme. Shkup: Furkan ISM.
- Kambovski, V., Maloletnicka pravda, Shkup, 2008
- Кнежевиќ, С. (2010). Малолетничко кривично право- материално, процесно и извршно, Проект: Право на пристап правосуду, Ниш.
- Kryerës të veprave penale në 2013. Shkup: !Perpetrators od criminal offences in 2013", Statistical revieë / Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.14.11 (789) p.117. (2014).

- Kryerës të veprave penale në 2014. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2014", Statistical revieë / Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.15.12 (823) p.115. (2015).
- Kryerës të veprave penale në 2015. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2015", Statistical revieë, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.16.08 (8544). (2016).
- Kryerës të veprave penale në 2017 Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2015", Statistical revieë, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.18.07 (898)
- Latifi, V. (1982). Kriminalistika e delikuencës së të miturve. Prishinë: Rilindja.
- Latifi, V., Elezi, I., Hysi ,V. "POLITIKA E LUFTIMIT TË KRIMINALITETIT", Prishtinë, 2012
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit" -1985), United Nation Standard Minimum Rules for the juvenile justice (The Beging Rules)
- Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF. (2016). Raport Vjetor për Punën e Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve dhe për gjendjet në sferën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së fëmijëve në vitin 2015. Shkup: Këshilli Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990); United Nation Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty (Havana Rules)
- Sahiti E., Zejneli I. (2007, 2017). E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë. Tetovë.
- Sahiti, E. (1993). Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale. Prishtinë.
- Strategjia për Parandalim. (2010). Strategjia Nacionale për parandalim të delikuencës së të mituve 2010-2020. Shkup: Këshilli Shtetëror për parandalim të delikuencës së të

miturve ("Национална Стратегија за Превенција на Малолетничко Престапништво 2010-2020").

- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Rijadit); Titulli original: UN Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency (Riyadh Guidelines)
- Zejneli, I. (2008). Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë. Tetovë.
- Zejneli, I. (2018). Delikuenca e të miturve. Tetovë/ Prishtinë.

KONVENTA, KUSHTETUTA, KODE, LIGJE

- Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës 1989 (Convention on the Rights of the Child- (CRC))
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 52 nga 22.11.1992 me Amandamentet plotësuese I-XXXII. Shkup.
- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr: 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014.
- Ligji penal i Republikës Socialiste të Federatës Jugosllave. "Gazeta Zyrtare e F.D." nr. 44/76, 34/84, 74/84, 57/89, 3/90,38/90, dhe "G.Z. e R.M." nr. 25/92, 32/93.
- Ligji penal i Republikës Socialiste të Maqedonisë. " Gazeta Zyrtare e R.S.M.", nr. 25/77, 23/84, 50/87, 36/89,7/90, 23/91, 24/92, 49/93.
- Ligji për drejtësinë e të miturve i Republikës së Maqedonisë. (2007). ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2007, 103/2008, 161/2008 dhe 145/10).
- Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 148 /2013.

- Ligji mbi Policinë i Republikës së Maqedonisë (Tekst i Spastruar). (Mars, 2015). ("Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 114/04, 6/09, 145/12, 41/14, 33/15, 148/08).

PUBLIKIME NË SAJTE

- <http://ëëë.slvesnik.com.mk/content/Ustav%20na%20RM%20-%20makedonski%20-%20FINALEN%202011.pdf>
- <https://ëëë.zeriamerikes.com/a/drejtesia-per-te-mitur/2939399.html>. (31.08.2016).
- <https://ëëë.unicef.org>.
- <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-Alb.pdf>